



Komuna e Vushtrrisë  
Opština Vučitrn  
Municipality of Vushtrri




Universiteti për Biznes dhe  
Teknologji

# STRATEGJIA PËR VUSHTRRINË QYTET I MENÇUR DHE I QËNDRUESHËM

Qytet i mençur, i qëndrueshëm dhe i qasshëm

UBT - Instituti për Studime Urbane  
dhe Planifikim Hapësinor

TETOR, 2021



# SMART CITY KOSOVA

## **Parathënje**

*Duke përfshirë 5 universitete nga 5 vende të ndryshme (Universiteti për Biznes dhe Teknologji - Kosovë, TU Wien-Austri, ETH Zurich-Zvicerr, HafenCity Universitat-Gjermani dhe Mimar Sinan Fine Arts University, Turqi) me më shumë se 20 ekspertë nga akademia dhe ekspertë të tjerë nga institucionet partnere dhe industria, projekti 'Smart City Kosova' synon të përgatisë dhe komunikojë strategji gjithëpërfshirëse të qyteteve të mençura, të cilat do t'u sigurojnë qyteteve tona qasje inovative ndaj problemeve lokale dhe t'u ndihmojnë atyre të promovojnë dhe gjenerojnë një zhvillim të qëndrueshëm urban.*

*Me dimensionet e tij teknologjike dhe jo-teknologjike, projekti Smart City Kosova mund të ndihmojë në kapërcimin e kufizimeve të zhvillimit tradicional urban që ka tendencë për të menaxhuar sistemet e infrastrukturës urbane me qasje dhe teknika jo adekuate. Duke përdorur teknologjitë dixhitale, të tilla si Open Data, projekti ndër të tjera ndihmon në lidhjen e palëve të ndryshme të interesit, përmirësimin e përfshirjes së qytetarëve në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes, përmirësimin e shërbimeve ekzistuese dhe ofrimin e shërbimeve më të reja dhe dhe sigurimin e qasjes tematike ndaj problemeve specifike të qyteteve tona. Zhvillimi i Qytetit të Mençur është, gjithsesi, shumë kompleks, sfidues dhe specifik.*

*Teknologjia e qyteteve të mençura, midis shumë përfitimeve të tjera, mund të ndihmojë qytetet të operojnë në mënyrë më efektive, duke përmirësuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset. Kështu, përfitojnë institucionet qendrore e lokale, bashkë me qytetarët dhe mjedisin.*

*Karakteristikë e kësaj qasjeje është edhe përvetësimi i perspektivave gjithëpërfshirëse dhe i zhvillimit të koncepteve të reja, i cili konsiston në renditjen / prioritizimin e iniciativave si dhe koordinimin e të gjitha palëve të involvuara në proces.*

*Përfundimisht; duke u ofruar qyteteve tona strategji konkrete për t'i menaxhuar nevojat e tyre momentale dhe kërkesat në të ardhmen, ne do t'u ndihmojmë atyre në procesin e transformimit – përmes teknologjisë- drejt qytete të mençura, me më shumë hapësira publike dhe të gjelbërta, me transport urban e trafik të menaxhueshëm, me rauajte dhe promovim të identitetit urban e trashëgimisë kulturore, me dixhitalizim të shërbimeve publike, me mbrojtje radikale të burimeve dhe mjedisit. Rrjedhimisht u ndihmojmë atyre në procesin e transformimit në hapësira urbane të jetueshme.*

*Për arritjen e qëllimeve të tij, ky projekt përfshinë analizimin e praktikave më të mira globale për të adresuar problemet lokale dhe për t'u siguruar qyteteve tona strategji autentike, të përshtatshme dhe të zbatueshme.*

*Komuna e Vushtrrisë është ndër komunat e para që iu kanë bashkuar iniciativës së UBT- Institutit për Studime Urbane dhe Planifikim Hapësinor për projektin “Smart City Kosova” dhe rrjedhimisht është ndër komunat e para që po përvetëson dhe do t'a jetësojë në praktikë këtë koncept.*

## Përmbajtja

1. HYRJE .....	2
2. KORNIZA KONCEPTUALE PËR QYTETIN E MENCUR DHE TË QËNDRUESHËM .....	4
2.1. SHTYLLAT E QYTETIT TË MENCUR .....	4
2.2. KARAKTERISTIKAT E QYTETIT TE MENCUR.....	5
2.3. PËRFITIMET E IMPLEMENTIMIT TË KONCEPTIT QYTET I MENCUR.....	5
2.3.2. Përfitimet kryesore të transformimit të qyteteve .....	6
2.4. PËRMBLEDHJE E PRAKTIKAVE TË MIRA GLOBALE PËR STRATEGJITË PËR QYTETE TË MENCURA .	8
2.4.1. Smart City Wien: Strategjia.....	8
2.4.2. Zagreb Smart City: Strategjia .....	9
3. PROFILI KOMUNAL DHE URBAN I QYTETIT TË VUSHTRRISË .....	10
4. VIZIONI PËR VUSHTRRINË QYTET TË MENCUR DHE TË QËNDRUESHËM .....	15
5. TRAJTIMI I TEMAVE ME PRIORITET.....	19
5.1. MENAXHIMI I MENCUR I TRASHËGIMISË KULTURORE .....	19
5.1.1. Propozim për menaxhimin e mençur të trashëgimisë kulturore në Vushtrri .....	19
5.2. BIBLIOTEKA DIXHITALE .....	23
5.3. ARKIVA DIXHITALE .....	24
5.4. SISTEMI ELEKTRONIK PËR LEJE NDËRTIMORE (E-LEJA) .....	25
5.5. RRJETI I INTEGRUAR I WI-FI PUBLIK .....	26
5.5.1. Zgjidhja e propozuar për qytetin e Vushtrrisë, për Rrjetin e Integruar të Wi-Fi Publik.....	27
5.6. DIZAJN I INTEGRUAR DHE I QËNDRUESHËM I HAPËSIRAVE TË GJELBËRTA DHE ATYRE PUBLIKE	29
5.6.1. Zgjidhja e propozuar për Dizajnin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të Hapësirave të.....	31
Gjelbërta dhe Publike për Qytetin e Vushtrrisë .....	31

# 1. HYRJE

Kjo strategji, e cila trajton në mënyrë të integruar konceptet “Smart City” dhe “Sustainable City” synon t’i ofrojë qytetit të Vushtrrisë një strategji konkrete për t’i menaxhuar nevojat momentale dhe kërkesat në të ardhmen, duke e ndihmuar atë në procesin e transformimit – përmes teknologjisë- drejt qytetit të mençur dhe ekologjik, me më shumë hapësira publike dhe të gjelbërta, me transport të qëndrueshëm urban e trafik të menaxhueshëm, me ruajtje dhe promovim të identitetit urban e trashëgimisë kulturore, me dixhitalizim të shërbimeve publike, me mbrojtje strikte të burimeve dhe mjedisit. Rrjedhimisht synon t’a ndihmojë atë në procesin e transformimit në një qytet më të jetueshëm dhe me mundësi të barabarta për të gjithë.

Edhe qëllimi por edhe objektivat e kësaj strategjie janë në përputhje të plotë me Vizionin dhe me Qëllimet dhe Objektivat zhvillimore të Planit Zhvillimor Komunal të komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2024, e të cilat janë trajtuar në kapitullin IV të kësaj strategjie.

Për arritjen e qëllimeve të saj, kjo strategji përfshinë analizimin e praktikave më të mira globale për të adresuar problemet lokale dhe për t’i siguruar qytetit të Vushtrrisë strategji autentike, të përshtatshme dhe të realizueshme.

Sa i përket metodologjisë së punës e cila është ndjekur për të hartuar këtë Strategji; së pari është punuar në bazën konceptuale të konceptit “Smart City”, duke e shtjelluar konceptin, nevojën për të si dhe përfitimet kyçe të qyteteve të cilat e përvetësojnë këtë koncept dhe e orientojnë zhvillimin e ardhshëm të tyre duke u bazuar në karakteristikat e zhvillimit të mençur dhe të qëndrueshëm. Bashkë me shtjellimin e konceptit janë evidentuar edhe shembuj nga strategjitë e qyteteve të tjera Europiane për orientim drejt zhvillimit të mençur dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë edhe shembuj të projekteve konkrete të realizuara në këto qytete. Pas kornizës konceptuale dhe analizimit të shembujve konkret për Smart City është analizuar profili komunal dhe urban i qytetit të Vushtrrisë, duke i theksuar karakteristikat dhe të dhënat më të rëndësishme, e të cilat përbëjnë bazën e zhvillimit të ardhshëm të qytetit në kontekst të kësaj strategjie. Pasi janë përcaktuar objektivat strategjike për të realizuar vizionin për Vushtrrinë Qytet të Mençur dhe Ekologjik, projektet dhe veprimet konkrete janë ndarë në 3 faza/afate kohore: Projektet afatshkurtër, projektet afatmesëm dhe projektet afatgjatë. Mirëpo në këtë draft strategji janë paraqitur vetëm projektet afatshkurtër të cilat do të realizohen deri në fund të Dhjetorit 2021<sup>1</sup>.

**Strategjia për Vushtrrinë Qytet të Mençur dhe të Qëndrueshëm** mbështetet në 6 objektiva strategjike, të cilat përfshijnë aspektin socio-ekonomik, mjedisor, infrastrukturor si dhe komponentën e qeverisjes transparente lokale. Objektivat strategjike jani si vijon:

- 1) Arritje e balancit në trekëndëshin e komponenteve sociale, ekonomike dhe mjedisore, për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke ia shtuar edhe komponentën e qeverisjes transparente dhe gjithëpërfshirëse;
- 2) Qytet Miqësor me Natyrën i bazuar në energji të gjelbërt dhe të pastërt, reduktim të emetimeve, hapësira të gjelërta dhe hapësira tjera publike të integruara dhe të qasshme për të gjithë, qytet i përshtatshëm për ecje dhe për ciklizëm që derivon nga Plani për EkoMobilitet;

---

<sup>1</sup> Kompletimi i Strategjisë për Vushtrrinë Qytet të Mençur dhe të Qëndrueshëm është planifikuar të bëhet deri në Qershor 2022

- 3) Shërbime Publike Dixhitale: Libraria Dixhitale, Arkiva Dixhitale, Sistemi Dixhital për Leje Ndërtimore, Shërbimet tjera komunale të dixhitalizuara, Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH);
- 4) Platforma e-Vushtrria (burim i hapur për të gjithë dokumentet e planifikimit hapësinor dhe sektorial, dokumentet zyrtare, shërbimet publike dhe private, biznesin lokal dhe shpalljet e vendeve të reja të punës);
- 5) Shërbime Publike dhe Infrastrukturë Teknike e Mencur:
  - Menaxhim i Mencur dhe i Integruar i Resurseve Ujore
  - Sistem i Mencur i Transportit, Menaxhim i Mencur i Trafikut dhe Parkingjeve
  - Infrastrukturë publike sociale e qasshme për të gjithë, e bazuar në Principet e Dizajnit Universal;
- 6) Ruatje strikte e burimeve natyrore dhe kulturore si dhe promovim i trashëgimisë kulturore për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit: Arritja e balancit Ruatje – Përdorim.

Krahas këtyre objektivave strategjike, janë identifikuar temat më prioritate të cilat kërkojnë ndërhyrje në plan afatshkurtër (Shtator 2021 – Dhjetor 2021), e të cilat janë identifikuar pas analizave gjithëpërfshirëse. Në këtë mënyrë, për qytetin e Vushtrrisë janë identifikuar 5 temat vijuese për trajtim me prioritet në kuadër të kësaj strategjie:

1. Menaxhimi i Mencur dhe i Integruar i Trashëgimisë Kulturore
2. Dixhitalizimi i Bibliotekës së qytetit dhe i Arkivës Komunale
3. Dixhitalizimi i shërbimit për leje ndërtimore (e-Leja)
4. Rrjeti i Integruar për Wi-Fi publik në zonën urbane, i qasshëm për të gjithë dhe pa pagesë
5. Rrjeti i Integruar i Hapësirave të Gjelbërta dhe atyre Publike në zonën urbane

Për secilën nga këto tema janë bërë analiza të detajizuara si dhe janë propozuar zgjidhje innovative dhe të qëndrueshme. Këto propozime/zgjidhje, përvec se do të implementohen në praktikë, si të tilla do të reflektojnë Vizionin dhe Objektivat Strategjike të Strategjisë Gjithëpërfshirëse për Vushtrrinë Qytet të Mencur dhe të Qëndrueshëm.


## 2. KORNIZA KONCEPTUALE PËR QYTETIN E MENCUR DHE TË QËNDRUESHËM

Deri në vitin 2050 vlerësohet se afërsisht 70% e popullsisë së botës do të jetojë në qytete. Me më shumë qytetarë për të shërbyer dhe një klimë që po degradon me shpejtësi, efikasiteti i shërbimit publik dhe përdorimi efektiv i burimeve po bëhen çështje urgjente për qytetet. Në këtë kontekst, sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe cilësisë së jetës në ekosistemet komplekse sociale të qyteteve dhe zonave urbane janë shqetësime të rëndësishme. Qytetet janë gjithnjë e më të vetëdijshëm për konceptin e "Smart City" dhe po zhvillojnë në mënyrë aktive strategji drejt qëllimit për t'u bërë "të zgjuar" dhe menaxhojnë burimet e qytetit në mënyrë më efikase duke adresuar sfidat e zhvillimit dhe përfshirjes. Për të kuptuar konceptin e Smart City, duhet të fillojmë me kuptimin e koncepteve të përafërta me modelin në fjalë. Nocioni i qytetit të zgjuar krijohet nga kombinimi i shoqërisë së dijes dhe qytetit dixhital. Është përcaktuar si një "sistem territorial shumë- shtresor i inovacionit" i përbërë nga rrjete dixhitale, kapitali intelektual individual dhe kapitali social i qytetit, të cilat së bashku përbëjnë inteligjencën kolektive (Komninos, 2008) [13]. Konkurrenca ekonomike dhe inovacioni i arritur përmes ekonomisë së bazuar në njohuri e bën një qytet inteligjent, duke e lejuar atë të krijojë një "avantazh konkurrues hapësitor" përmes zonave industriale, rajoneve dhe grupeve mësimore që prodhojnë H&ZH (Hulumtim dhe Zhvillim) të sofistikuar dhe mbështeten nga rrjetet dixhitale dhe inteligjenca artificiale.

### 2.1. SHTYLLAT E QYTETIT TË MENCUR

Bazuar në eksplorimin e një grupi të gjerë të literaturës nga fusha të ndryshme disiplinore, gjashtë shtyllat ose faktorët e Smart City janë: (1) Social, (2) Menaxhimi, (3) Ekonomia, (4) Mjedisi, (5) Teknologjia dhe (6) Qëndrueshmëria. Këto shtylla formojnë bazën e një kuadri integrues. Kjo gjithëpërfshirje është faktori dallues i Smart City, i cili integron komponentë fizikë, institucional dhe dixhital për të krijuar një përkufizim tërësor të asaj se si do të dukej planifikimi i zgjuar.

Në thelbin e tij, një kornizë e Smart City shfrytëzon mjedisin ekzistues ligjor, ekonomik dhe teknik dhe ndikon në aspektet sociale dhe të menaxhimit në mënyrë të qëndrueshme. Vendosija e një vizioni të Smart City dhe lëvizja efektive drejt tij me një qasje të bazuar në sisteme është e domosdoshme për të siguruar efikasitet dhe siguri optimale të burimeve, së bashku me ruajtjen e rritjes gjithëpërfshirëse shoqërore. Secili nga këta faktorë i mundëson si sektorit publik ashtu edhe atij privat të planifikojë dhe zbatojë nismat e Smart City në mënyrë më efikase. Kuadri tregon se secili faktor ndikon dhe ndikohet nga njëri faktor tjetër. Gjithashtu tregon se disa faktorë mund të jenë më me ndikim se të tjerët në varësi të kontekstit. Një qasje me fokus në qytetarët dhe e përshtatur kontekstualisht, duke përdorur burimet njerëzore dhe teknologjike, mund të sjellë përfitime të shumta për komunat, veçanërisht ato që po luftojnë me probleme specifike- të tilla si sistemet joefikase të menaxhimit të mbeturinave, mungesa e pjesëmarrjes qytetare, ose mbingarkesa në trafik.



## 2.2. KARAKTERISTIKAT E QYTETIT TE MENCUR

Sugjerohet që një Smart City (gjithashtu komuniteti, grupi i biznesit, grumbullimi urban ose rajoni) përdor teknologjitë e informacionit për:

- të përdorur në mënyrë më efikase infrastrukturën fizike (rrugë, mjedis të ndërtuar dhe pasuri të tjera fizike) përmes inteligjencës artificiale dhe analitikës së të dhënave për të mbështetur një zhvillim të fortë dhe të shëndetshëm ekonomik, social, kulturor.
- t'u angazhuar në mënyrë efektive me njerëzit lokalë në qeverisjen dhe vendimmarrje duke përdorur procese të hapura inovative dhe pjesëmarrje elektronike, duke përmirësuar inteligjencën kolektive të institucioneve të qytetit përmes e-qeverisjes, me theks të vendosur në pjesëmarrjen dhe bashkë-dizajnin e qytetarëve.
- të mësuar, përshtatatur dhe zhvilluar dhe në këtë mënyrë për t'iu përgjigjur në mënyrë më efektive dhe të shpejtë ndryshimit të rrethanave duke përmirësuar inteligjencën e qytetit.

## 2.3. PËRFITIMET E IMPLEMENTIMIT TË KONCEPTIT QYTET I MENCUR

### 2.3.1. Qyteti i Mencur për Zhvillim të Qëndrueshëm

Ekzistojnë disa modele urbanizimi që përfshijnë teknologji dixhitale për të adresuar disa nga sfidat e urbanizimit dhe qëndrueshmërisë:

**Qytetet Dixhitale** paraqesin integrimin e teknologjisë dixhitale në sistemet kryesore të infrastrukturës së qytetit;

**Qytetet Inteligjente** mbështeten në infrastrukturën dixhitale të qytetit për të ndërtuar ndërtesa inteligjente, sisteme transporti, shkolla, ndërmarrje, hapësira publike, shërbime publike, etj dhe për t'i integruar ato në sistemet inteligjente urbane; dhe

**Qytetet e Mencura**-vendosin sisteme urbane inteligjente në shërbim të zhvillimit socio-ekonomik dhe përmirësimit të cilësisë së jetës urbane.

Me dimensionet e tij teknologjike dhe jo-teknologjike, koncepti Qytet i Mencur mund të ndihmojë në kapërcimin e kufizimeve të zhvillimit tradicional urban që ka tendencë për të menaxhuar sistemet e infrastrukturës urbane me qasje dhe teknika jo adekuate. Duke përdorur teknologjitë dixhitale, të tilla si Open Data, koncepti ndër të tjera ndihmon në lidhjen e palëve të ndryshme të interesit, përmirësimin e përfshirjes së qytetarëve në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes, përmirësimin e shërbimeve ekzistuese dhe ofrimin e shërbimeve më të reja dhe dhe sigurimin e qasjes tematike ndaj problemeve specifike të qyteteve tona. Zhvillimi i Qytetit të Mencur është, gjithsesi, shumë kompleks, sfidues dhe specifik.

Tutje; duke u ofruar qyteteve tona mundësi konkrete për t'i menaxhuar nevojat e tyre momentale dhe kërkesat në të ardhmen, ai i orineton ato nga transformimi – përmes teknologjisë- drejt qyteteve të mençura, me më shumë hapësira publike dhe të gjelbërta, me transport urban e trafik të menaxhueshëm, me rruajtje dhe promovim të identitetit urban e trashëgimisë kulturore, me dixhitalizim të shërbimeve publike, me mbrojtje radikale të burimeve dhe mjedisit. Rrjedhimisht u ndihmon atyre në procesin e transformimit në hapësira urbane më të jetueshme.

### 2.3.2. Përfitimet kryesore të transformimit të qyteteve

Teknologjia e qyteteve të mençura, midis shumë përfitimeve të tjera, mund të ndihmojë qytetet të operojnë në mënyrë më efikase, duke përmirësuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset. Kështu, përfitojnë institucionet qendrore e lokale, bashkë me qytetarët dhe mjedisin.

Karakteristikë e kësaj qasjeje është edhe përvetësimi i perspektivave gjithëpërfshirëse dhe i zhvillimit të koncepteve të reja, i cili konsiston në renditjen / prioritizimin e iniciativave si dhe koordinimin e të gjitha palëve të involvuara në proces. Në këtë kontekst, më poshtë janë radhitur benefitet potenciale të qyteteve tona nga strategjitë për Qytete të Mençura:

- a) Ulja e emetimeve duke u përqëndruar në Jetesë, Ambient Pune, Mobilitet dhe Hapësira Publike të Qëndrueshme;
- b) Përdorimi më efikas i infrastrukturës fizike përmes inteligjencës artificiale dhe analizave të të dhënave për të mbështetur një zhvillim të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm ekonomik, shoqëror, kulturor dhe infrastrukturor;
- c) Angazhimi në mënyrë efektive i qytetarëve në qeverisjen lokale dhe vendimmarrje përmes përdorimit të pjesëmarrjes elektronike, përmirësimit të inteligjencës kolektive të institucioneve lokale përmes qeverisjes elektronike.
- d) Avancimi i konceptit të Qytetit të Hapur;
- e) Transport dhe Infrastrukturë e përmirësuar: Mobilitet Urban më i qëndrueshëm dhe efikas, komunikim dhe qasje më e lehtë;
- f) Përfitimet e Efikasitetit: Shërbime publike eficiente dhe ulje e kostos
- g) Ndikimi në mjedis: Zvogëlim i dëmeve në mjedis dhe arritja e qëndrueshmërisë mjedisore;
- h) Prosperiteti ekonomik, rritja e angazhimit të forcës punëtore: Qytet tërheqës dhe miqësor ndaj biznesit;
- i) Mbrojtje strikte e burimeve natyrore dhe kulturore;
- j) Kualitet i lartë i jetës dhe drejtësi sociale: Qytetet për njerëzit;
- k) Më shumë hapësira publike dhe zona të gjelbërta;
- l) Qytete më të përshtatshme për ecje dhe më të jetueshme;
- m) Transparenca dhe kultura demokratike;
- n) Qasje universale në kulturë, arsim, shëndetësi etj..



Për të përmbledhur, këto janë përfitimet kyçe që i karakterizojnë qytetet e mençura:

- Angazhimi në mënyrë efektive i qytetarëve në qeverisjen lokale dhe vendimmarrje
- Dixhitalizim i shërbimeve publike
- Transport dhe Infrastrukturë e përmirësuar: Mobilitet i qëndrueshëm, komunikim më i lehtë;
- Përfitimet e Efikasitetit: Shërbime publike efiçiente dhe Kursim i Kostos
- Ndikimi në mjedis: Zvogëlimi i dëmeve mjedisore dhe arritja e qëndrueshmërisë së mjedisit;
- Kualitet i lartë i jetës;
- Prosperiteti ekonomik, rritja e angazhimit të forcës punëtore;
- Qasje universale në kulturë, arsim, shëndetësi etj

## 2.4. PËRMBLEDHJE E PRAKTIKAVE TË MIRA GLOBALE PËR STRATEGJITË PËR QYTETE TË MENCURA

### 2.4.1. Smart City Wien: Strategjia

Vjena është renditur e para për strategjinë e “Smart City”, dhe kjo falë kornizës dhe strategjisë së saj të integruar, ndërsa "mbrojtja e burimeve, inovacioni dhe cilësia e jetesës janë objektivat e Strategjisë në kuadër të Smart City Vjenë".

Konsiderohet se Vjena po funksionon dhe po zhvillohet shumë mirë - në transport, ndërtim banesash, zhvillim urban, mbrojtje të mjedisit, shërbime të furnizimit dhe depozitimit të mbeturinave si dhe shërbime sociale për popullatën, dhe pritet që e gjithë kjo të funksionojë edhe më mirë në të ardhmen.

Duke synuar të shtrihet nga tani në vitin 2050, “Iniciativa e Smart City Vjena” u lançua në 2011 nën kujdesin e Kryetarit Michael Häupl, ndërsa shkëmbimi me qytete të tjera evropiane pritet të shërbejë si një stimul për krijimin e një rrjeti të qyteteve të zgjuara evropiane.

Megjithëse dihet fakti se ndryshimet e nevojshme në sektorët e energjisë, lëvizshmërisë ose ndërtimit nuk mund të ndodhin brenda natës, objektivi kryesor i iniciativës është i qartë: Vjena dëshiron të zvogëlojë konsumin e burimeve të saj në mënyrë të konsiderueshme ndërsa vazhdon të ofrojë cilësi të shkëlqyeshme të jetesës dhe sigurisë për të gjithë.

#### **Një pikënisje e shkëlqyer**

Konsiderohet se pika fillestare e Vienës për t'u bërë një qytet i zgjuar është e shkëlqyeshme, veçanërisht në fushat e mëposhtme: Banimi social, transporti publik, biznesi, uji i Vjenës, menaxhimi i mbeturinave dhe hapësirat e gjelbra.

*Vizioni i strategjisë është "Kjo mund të jetë Vjena në 2050".*

Objektivi kryesor i “Smart City Vjenë” për vitin 2050 është: cilësia më e mirë e jetesës për të gjithë njerëzit në qytet: e kombinuar me ruajtjen maksimale të burimeve, e cila vjen nga risitë gjithëpërfshirëse.

Në mënyrë të veçantë “Smart City Vjenë” përshkruan zhvillimin e një qyteti bazuar në:

- Mbrojtjen radikale të burimeve
- Perspektivën holistike
- Cilësinë e lartë, të drejtë shoqërore të jetës
- Përdorimin produktiv të inovacioneve/teknologjisë së
- Një qytet i përcaktimit të kodit dhe drejtësisë sociale
- Një qytet me hapësira të gjelbra dhe energji të ripërtrishme
- Një qytet me mundësi të barabarta për të gjitha brezat
- Një qytet për të rinjtë nga e gjithë bota

## 2.4.2. Zagreb Smart City: Strategjia

### ***Vizioni: Qyteti i Zagrebit si një inkubator urban i koncepteve të qëndrueshme, sipërmarrjes dhe vlerave të reja***

Objektivi themelor i strategjisë është që të bëhet një qytet më i mirë/më i zgjuar brenda 10 viteve të ardhshme në të gjitha fushat kryesore të jetesës - nga arsimi, ekonomia, transporti, energjia dhe qeverisja - të gjitha të ndërlidhura dhe të lidhura përmes një infrastrukture të përbashkët TIK e cila do të mundësojë përdorimin e teknologjive më të fundit dhe zgjidhjeve të zgjuara siç janë Big Data, IoT (Internet of Things) dhe të tjera. Për ta bërë këtë, “Zagreb – Strategjia e Smart City” përcakton objektivat kryesore dhe masat prioritare për periudhën e ardhshme 10-vjeçare.

Duke u bazuar në një qasje tërësore, duke pasur parasysh qëllimin përfundimtar - të rrisë cilësinë e jetës së të gjithë banorëve të qytetit, “Zagreb – Strategjia e Smart City” mbledh së bashku përfaqësues të të gjitha departamenteve, institucioneve, agjencive përkatëse të qytetit, si dhe kompanisë Zagreb Holding Ltd, me atë që është në pronësi 100% të Qytetit dhe përgjegjës për ofrimin e shërbimeve publike në Qytetin e Zagrebit - transport, furnizim me ujë, furnizim me gaz, menaxhim të mbeturinave, etj. Përveç kësaj, ekspertë të përfshirë në përgatitje të strategjisë përfshijnë profesionistë nga kompanitë kryesore të TIK -ut në Kroaci.

Brenda fushës së "Drejtimeve të Zhvillimit Strategjik", një numër i Projekteve dhe Shërbimeve Smart janë planifikuar si më poshtë:

- Wi-Fi falas
- Qasje të hapur në të dhëna
- Kartë Sociale
- Fabrika e “Start-up”ave
- Karta e Qytetit të Zagrebit
- Menaxhimi automatik i trafikut
- ZG "ndjeni ajrin"
- Buxhet i hapur
- “My Zagreb”
- Zhvillimi i menaxhimit të procesit të biznesit

Objektivi: Administrim efektiv, ekonomik, transparent, fleksibil, i fokusuar tek qytetarët.

Kategoritë kryesore të identifikuara (me nënsektorë për secilin) në vizionin dhe qëllimet për 2027:

- Cilësia e jetës
- Ekonomia
- Menaxhimi dhe informacioni
- Mbrojtja e Mjedisit dhe Zbutja e Ndryshimeve Klimatike

### 3. PROFILI KOMUNAL DHE URBAN I QYTETIT TË VUSHTRRISË

#### Profili i Komunës së Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veriore të Republikës së Kosovës dhe kufizohet me komunën e Mitrovicës, Podujevës, Obiliqit, Drenasit dhe të Skenderajit. Ka një sipërfaqe prej 345 km<sup>2</sup> dhe zë rreth 3.2 % të territorit të Kosovës. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë (2011), në këtë komunë jetojnë 69870 banorë ku dendësia e popullsisë është rreth 202 banor për km<sup>2</sup>.





Fig. 1: Pozita gjeografike e komunës së Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë ka gjithsej 67 vendbanime, me 66 fshatra dhe vet qytetin e Vushtrrisë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në vendbanimet rurale jetojnë 42906 banorë apo 61.4 % dhe në qytetin e Vushtrrisë jetojnë 26964 banorë apo 38.6 %.



Graf. 1: Trendi i rritjes së popullsisë urbane dhe rurale sipas regjistrimeve në Kosovë


Sipas të dhënave nga grafiku nr. 1 vërehet se numri i popullsisë si në qytet ashtu edhe në fshatrat e Vushtrrisë ka shënuar një rritje të vazhdueshme nga viti 1948 deri rreth viteve të 90-ta. Pas viteve të 90-ta, për shkak të rrethave të krijuara si nga aspekti politik, ekonomik, social dhe vet Lufta e e fundit në Kosovë kanë ndikuar në rënjen e numrit të popullsisë si në zonën urbane ashtu edhe në vendbanimet rural. Deri në vitet e 70-ta kishim një rritje të lehtë popullsisë, ndërësa rritja më e theksuar e popullsisë u shënua në periudhën mes viteve 1971-1991.

Komuna e Vushtrrisë shtrihet mes dy qendrave të mëdha urbane të Kosovës: Prishtinës dhe Mitrovicës. Relievi i komunës është i ulët fushor dhe kodrinor që është pjesë përbërëse e masës malore të Kopaonikut dhe Qyqavicës. Klima e komunës është e butë me tipare të klimës kontinentale. Lumi Sitnica është lumi kryesor që përshkon territorin e kësaj komune, ndërësa dy lumenjt më të vegjël janë tërstena dhe Studimja që kalojnë nëpër qytetin e Vushtrrisë. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore kanë mundësuar që kjo komunë të ket lidhje të mira me qendrat tjera tjera të Kosovës por edhe më gjërë. Poashtu, në hapësirat e kësaj komune shtrihen toka bujqësore mjaft pjellore dhe të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë.

Lidhjet e mira të Vushtrrisë mundësohen përmes hekurudhës dhe rrugëve automobilistike që lidhin këtë komunë me kryeqendrin e Kosovës –Prishtinën dhe atë të Maqedonisë së Veriut – Shkupin. Në veri kemi lidhjen me Mitrovicën dhe me Serbinë. Lidhjet kryesore të kësaj komune bëhen kryesisht përmes vijës hekurudhore Fushë Kosovë – Mitrovicë dhe rrugës Magjistrale Prishtinë – Mitrovicë.

Në gjysmën e parë të shekullit XX, veprimtaritë kryesore ekonomike në komunën e Vushtrrisë kanë qenë: bujqësia, blegtoaria, tregtia dhe zejtoaria (lekurëpunues, metal përpunues, pelhurë punues). Mes viteve 1979 – 1980 u ngriten një mori kapacitetesh industriale, siç ishin: Fabrika e Lllamarinës së Zinkuar, Fabrika e Konfeksionit, ajo e ngjyrave dhe llaqeve. Në vitin 1976 u aplikua masa e grupimit (komosacionit) të tokave që intensifikoi zhvillimin e bujqësisë së kësaj komune.

Zhvillimet e më vonshme kanë ndikuar që të zvogëlohen veprimtarit ekonomike primare dhe të rritet angazhimi dhe orientimi në aktivitete tjera ekonomike sekondare dhe sidomos në ato shërbyese. Bujqësia mbetet një nga sektorët me rëndësi të komunës së Vushtrrisë për shkak edhe të kushteve të volishme që ka. Megjithatë, në periudhat e fundit kohore kemi një rritje të veprimtarive të tjera ekonomike sidomos të tregëtisë, administrate, arsimit, energjetikës etj. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, kemi një rritje të konsiderueshme të angazhimit në veprimtari ekonomike shërbyese.



Graf. Përqindja e të punësuarve sipas veprimtarive ekonomike

Sipas të dhënave nga grafiku, angazhimi më i madh i të punësuarve në komunën e Vitisë është në administratë me 16.78 %, pastaj kemi tregëtinë me shumicë dhe pakicë me 16.72 %, Arsimin me 12.11 %, energjetik 11.98. të dhënat tregojnë për ndryshimet dhe transformimet që kanë ndodhur në strukturën ekonomike të komunës. Këto transformime tregojnë edhe për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të komunës.

### Historiku

Lashtësia e këtij qyteti dëshmohet nga gjetjet e shumta arkeologjike, linguistike dhe toponomastike. Vushtrria është njëra ndër qendrat më të vjetra urbane në Kosovë e ngritur në lokacionin e vendbanimit antic "Vicianum". Treva ku ndodhet qyteti supozohet të ketë kontinuitet të banimit që nga neoliti i vjetër. Kjo trevë përjeton shumë herët një zhvillim të bujshëm kulturor i cili manifestohet në fusha të ndryshme të jetës. Gjurmët e jetës urbane hasen në disa grehina të vjetra arkitektonike si ura, banja publike, çeshme, mullinj etj. Për here të parë Vushtrria bie nën sundimin Osman në vitin 1439 dhe për here të dytë në vitin 1455, bashkë me Novobërdën dhe Trepçën. Gjatë sundimit Osman ajo gëzon statusin e qendrës urbane dhe të selisë administrative në të cilën ushtrohen disa funksione. Gjatë kësaj periudhe ajo bën pjesë në kuadër të qyteteve të mëdha të Kosovës dhe të Gadishullit Ilirik. Si qendër e sanxhakut përmendet në vitin 1462, e cila përfshinte një territor të gjerë në kuadër të së cilës përfshihej Prishtina, Novobërda dhe Anamorava. Si qendër administrative e këtij territori të madh në shek. XV-XVIII Vushtrria prosperon dhe bëhet vendbanimi më i rëndësishëm në Rrafshin e Kosovës. Në shek. XVI cilësohet si qendër e madhe tregtare me dyqane dhe bujtina të shumta. Me ardhjen dhe vendosjen e tyre, osmanët i japin qytetit karakterin dhe pamjen orientale. Vushtrria dallohet me objekte të shumta të arkitekturës orientale, por edhe me objekte të antikitetit, pastaj me rrugë të ngushta të shtruara me kalldrëm, me xhami në çdo lagje, me shtëpi të banimit të rrethuara me mure e me kopshte etj. Objekte të shumta dëshmojnë për historikun e gjatë të ekzistimit si vendbanim urban: Ura e Vjetër e Gurit, Shtëpia e "Mahmut Agë Gjinollit", Hamami i qytetit, Kalaja e Vjetër, Xhamia e "Gazi Ali Beut", Xhamia "Karamanli", Sahatkulla, Teqeja e Qytetit, Muri i Badivukëve etj.

## **Ekonomia**

Në gjysmën e dytë të shek. të kaluar Vushtrria përjetoi një zhvillim të rëndësishëm ekonomik me disa degë industrial si industria metalike, e konfeksionit, industria kimike, e ndërtimtarisë etj. Veprimtaritë kryesore ekonomike gjatë gjysmës së parë të shek. XX ishin bujqësia, blegtoria, tregtia dhe zejtaria. Gjatë viteve 1979-1980 janë ngritur disa kapacitete industrial sikurse Fabrika e Lllamarinës së Zinkuar, Fabrika e Konfeksionit, Fabrika e Ngjyrave dhe e Llaqeve rtj. Në vitin 1976 bëhet komosacioni i tokave që nxit zhvillimin e bujqësisë së kësaj treve. Ndërmarrjet ekonomike që funksiononin në qytet ishin "Llamkos", "Vushteks", "Kosova", "Ekstra", dhe "Çiçavica" me mbi 1000 punëtor. Këto ndërmarrje funksionuan deri në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, kur hynë masat e dhunshme nga regjimi serb dhe u shkatrruan. Struktura ekonomike tani u reduktua në disa ndërmarrje tregtare dhe disa ndërmarrje industrial që janë fryt i iniciativës private familjare.

**Qyteti i Vushtrrisë** është qendër administrative, politike, ekonomike, arsimore, shëndetësore, kulturore dhe sportive e 67 vendbanimeve që shrihen në territorin e kësaj komune. Shtrihet në pjesën veriore të fushës së Kosovës dhe sipërfaqja e zones kadastrale është 1847.9 ha. Qyteti ka pozitë të volitshme gjeografike, me mundësi të shumta të lidhjeve komunikative tokësore në të gjitha anët. Ndodhet në jug-lindje të Mitrovicës në largësi prej 13 km, kurse nga Prishtina është larg rreth 27 km. Largësia nga Aeroporti Ndërkombëtar Prishtinës "Adem Jashari" është rreth 40 km. Pas Mitrovicës Vushtrria është vendbanimi më i madh në pjesën veriore të Rrafshit të Kosovës dhe njëra nga qendrat më të vjetra në këto troje e themeluar në lokacionin e një qyteti antik. Qyteti shtrihet rrëzë Kopaonikut në Veri-Lindje e deri te lumi Sitnica në pjesën qendrore të fushgropës së Kosovës. Në antikitetet përskaj Vushtrrisë kalonte rruga e vjetër Naissus – Lissus, e cila nëpër Ulpian dhe Kaçanik çonte për në Shkup (Scupi). Në përfundim të qytetit në anën e majt të lumit Sitnica kalon hekurudha e ndërtuar në vitin 1874, e cila nëpër fushën e Kosovës lidhte Mitrovicën me Selanikun. Sot nëpër të kalon rruga me rëndësi regjionale Mitrovicë – Prishtinë – Shkup.

### **Kushtet natyrore të qytetit të Vushtrrisë**


Vushtrria ndodhet në zonën gjeologjike-tektonike të Vardarit, përkatësisht në nënzonën e jashtme të saj. Territori i zones kadastrale ndërtohet nga shkëmbinj të moshave të ndryshme, ndër të cilët dominojnë ata të moshave të reja. Në pjesën lindore, në rrëzën e Kopaonikut hasen formacione vullkanike të përfaqësuara nga piroklasike me përmbajtje andezitike të moshës miocenike. Pjesa tjetër në L të qytetit ndërtohet nga shkëmbinj të moshës pliocenike të përfaqësuara nga rëra, argjila e zhavori. Qyteti është i vendosur në rrafshin alluvial dhe në tarracën lumore të Sitnicës, e cila karakterizohet me pjerrësi të vogël të relievit. Lartësia mbidetare e qytetit është 529 m, ndërsa pika më e lartë në zonën kadastrale është 665 m te maja Zhegina.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit është rreth 10,5°C. Gjatë vitit janë 2140 orë me diell, ose mesatarisht 5.8 orë/ditë. Reshjet mesatare vjetore janë 646 mm. Gjatë viti janë 97 ditë me reshje. Vlera mesatare e lagështisë së ajrit është 77%. Dominojnë erërat veriore, ndërsa ato VL janë më të pakta për shkak të Kopaonikut. Numri i ditëve me mjegull gjatë vitit është rreth 27 ditë. Qyteti ka klimë kontinentale, që veçohet me verë të nxehtë dhe dimra mjaft të ftohtë.

Në Perëndrim të qytetit kalon arteria kryesore lumore e fushë gropes së Kosovës, Sitnica, ujërat e së cilës rrjedhin në drejtim të Ibrit, që vazhdojnë deri në Detin e Zi. Nëpër qytet rrjedh lumi i Tërstenës, që është degë e djathtë e Sitnicës dhe në jug rrjedh lumi i Studimës.

## Popullsia

Në aspektin e zhvillimit demografik qyteti i Vushtrrisë kishte disa periudha të zhvillimit. Deri në vitet e 70-ta kishte një rritje shumë të vogël të popullsisë përkundër nomave të larta të shtimit natyror. Në vitin 1948 kishte 5813 banor dhe 1181 ekonomi familjare, ndërsa në vitin 1971 kishte 12334 banorë 2141 ekonomi familjare. Kjo tregon se për periudhë 23 vjeçare poullsia e qytetit është rritur vetëm për 6521 banorë. Periudha mes viteve 1971-1991 ka shënuar rritjen më të madhe të popullsisë. Në vitin 1971 kishte 12334 banorë, ndërsa në vitin 1991 kishte 30651 banor me një rritje prej 18317 banorë për 20 vite. Pas vitin 1991 për shkak të rrethanave të reja që u krijuan në Kosovë kishte një rënje të lehtë të numrit të popullsisë.



Lëvizja e numrit të popullsisë dhe ekonomive familjare në periudhë 1948-2011

## Zona urbane dhe funksionet

Territori urban është zgjeruar nga 180 ha, sa ishte në vitin 1970, në rreth 600 ha në vitin 2017, ose për 3.3 herë. Qendra e qytetit është ndër më të vjetrat në Kosovë. Ajo i jep identitet kësaj qendre urbane, duke dëshmuar për të kaluarën e hershme të saj. Në këtë zone zhvillohen disa funksione të rëndësishme shoqërore si administrative, educative-arsimore, shëndetësore, ekonomike, kulturore etj. Sheshi dhe parku i qytetit shfrytëzohen nga banorët për çlodhje dhe relaksim.

Zona veriore e qytetit me rreth 90 ha kufizohet me magjistralen Prishtinë – Mitrovicë, kurse në perëndim shtrihet deri te rruga kryesore e qytetit. Në këtë zone janë ndërtuar disa komplekse të banesave kolektive, me dy parqe të vogla dhe pastaj vazhdon me shtëpi të banimit individual. Këtu janë të koncentruara disa funksione shërbyese dhe arsimore sikurse Shkolla Fillore, Akademia Policore, Qendra e Mjekësisë Familjare etj. Zona jugore e qytetit karakterizohet me banim individual. Kohëve të fundit kanë filluar të ndërtohen edhe banesa kolektive. Pjesa lindore e kësaj zone, aty ku ndodhej stacioni I autobusëve tani tani më I rrënuar, po merr pamjen kompleksi i ri banesor.



## 4. VIZIONI PËR VUSHTRRINË QYTET TË MENCUR DHE TË QËNDRUESHËM

Vizioni për Vushtrrinë Qytet të Mencur dhe të Qëndrueshëm, bashkë me qëllimet dhe objektivat për të përmbushur këtë vizion janë në përputhje të plotë me Vizionin dhe me Qëllimet dhe Objektivat zhvillimore të Planit Zhvillimor Komunal të komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2024. Komuna e Vushtrrisë.

Në këtë kontekst janë analizuar Deklarata e Vizionit e PZHK 2016-2024, Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm të cilat targetohen me këtë strategji si dhe Qëllimet dhe Objektivat Tematike të PZHK- së të cilat po ashtu targetohen me këtë strategji.

### **Deklarata e Vizionit të Planit Zhvillimor Komunal 2016 – 2024<sup>2</sup>:**

*“Vushtrria, qytet i lashtë me trashëgimi të pasur kulturore. Vend me toka bujqësore, atraktiv dhe dinamik në zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit. Vend i turizmit malor – rekreativ dhe kulturorë, në mjedis të pastër ekologjik. Vend me potencial të madh të popullsisë së re dhe të kualifikuar.”*

### Qëllimet dhe Objektivat Zhvillimore

#### **Qëllimi 3: Vushtrria, qytet modern me rrënjë të lashta**

- Promovimi i përkrahjes së ndërmarrjeve turistike
- Ngritja e vetëdijes për turizmin
- Zhvillimi i një koncepti për mbrojtje dhe trashëgimi kulturore
- Ngritja e vetëdijesimit në popullsi për trashëgiminë kulturore

#### **Qëllimi 4: Shërbimet dhe infrastruktura në të gjitha pjesët e qytetit**

- Sigurimi i infrastrukturës teknike bazë... në të gjitha pjesët e qytetit.

#### **Qëllimi 5: Qyteti i gjelbër i Vushtrrisë**

- Mbrojtja e parqeve ekzistuese prej ndërtimeve dhe sigurimi i zonave për hapësira publike
- Mbrojtja e lumenjve dhe e zonave të tyre
- Lidhja e hapësirave të gjelbra, për të përmirësuar mikroklimën e qytetit

#### **Qëllimi 5 për zonat rurale: Mbrojtja e mjedisit, trashëgimia natyrore dhe kulturore**

Zhvillimi i konceptit komunal për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

---

<sup>2</sup> Dokument planifikimi. Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Plani Zhvillimor Komunal i Vushtrrisë 2016-2024.

Duke u nisur nga kjo, kjo strategji ka përcaktuar gjashtë objektiva strategjike, më qëllim të shndërrimit të qytetit të Vushtrrisë në Qytet të Mencur dhe të Qëndrueshëm:

- 1) Arritje e balancit në trekëndëshin e komponenteve sociale, ekonomike dhe mjedisore, për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke ia shtuar edhe komponentën e qeverisjes transparente dhe gjithëpërfshirëse.
- 2) Qytet Miqësor me Natyrën i bazuar në energji të gjelbërt dhe të pastërt, reduktim të emetimeve, hapësira të gjelërta dhe hapësira tjera publike të integruara dhe të qasshme për të gjithë, qytet i përshtatshëm për ecje dhe për ciklizëm që derivon nga Plani për EkoMobilitet;
- 3) Shërbime Publike Dixhitale: Libraria Dixhitale, Arkiva Dixhitale, Sistemi Dixhital për Leje Ndërtimore, Shërbimet tjera komunale të dixhitalizuara, Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH)
- 3) Platforma e-Vushtrria (burim i hapur për të gjithë dokumentet e planifikimit hapësinor dhe sektorial, dokumentet zyrtare, shërbimet publike dhe private, biznesin lokal dhe shpalljet e vendeve të reja të punës);
- 5) Shërbime Publike dhe Infrastrukturë Teknike e Mencur:
  - Menaxhim i Mencur dhe i Integruar i Resurseve Ujore
  - Sistem i Mencur i Transportit, Menaxhim i Mencur i Trafikut dhe Parkingjeve
  - Infrastrukturë publike sociale e qasshme për të gjithë, e bazuar në Principet e Dizajnit Universal;
- 6) Ruatje strikte e burimeve natyrore dhe kulturore si dhe promovim i trashëgimisë kulturore për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit: Arritja e balancit Ruatje – Përdorim.

## **Elaborimi i objektivave strategjike për Vushtrrinë Qytet të Mencur dhe të Qëndrueshëm**

### **Arritje e balancit në trekëndëshin e komponenteve sociale, ekonomike dhe mjedisore, për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke ia shtuar edhe komponentën e qeverisjes transparente dhe gjithëpërfshirëse**

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm, i cili për herë të parë është prezantuar nga Raporti Brundtland në 1987, definohet si "zhvillim që plotëson nevojat e gjeneratës së tanishme pa kompromentuar aftësinë dhe mundësitë e brezave të ardhshëm për t'i përmbushur nevojat e tyre". Zhvillimi i qëndrueshëm mund të arrihet përmes pesë parimeve udhëzuese, e që janë: të jetuarit brenda kufijve mjedisorë, sigurimi një shoqëri të fuqishme, të shëndetshme dhe të drejtë, zhvillimi e një ekonomie të qëndrueshme, promovimi i qeverisjes së mirë dhe përdorimi i teknologjisë së komunikimit të dhe informacionit si një përgjegjësi shoqërore.

### **Tri shtyllat e Zhvillimit të Qëndrueshëm**

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm është i bazuar në tre shtylla kryesore që synojnë të arrijnë rritje gjithëpërfshirëse si dhe të krijojnë prosperitet të përbashkët për brezin aktual dhe të vazhdojnë të plotësojnë nevojat e brezave të ardhshëm. Këto tre shtylla janë: Zhvillimi Ekonomik, Social dhe Mjedisor.

Këto shtylla janë të ndërlidhura mes vete dhe pasqyrojnë qëllimet e zhvillimit të komunitetit dhe stabilitetin social dhe mjedisor.

**Qëndrueshmëria Ekonomike:** Qëndrueshmëria ekonomike promovom ato aktivitete përmes të cilave mund të arrihet rritje ekonomike afatgjatë pa pasur ndikim negativ në aspektet mjedisore, sociale dhe kulturore të komunitetit.

**Qëndrueshmëria Sociale:** Qëndrueshmëria sociale është një formë e reflektimit të përgjegjësisë sociale. Ajo kombinon modelimin e mjedisit fizik me mjedisin social, përqendrohet në nevojat e shtresave të ndryshme në një komunitet dhe vë theks të veçantë në sigurimin e infrastrukturës së duhur dhe mbështetjen e nevojshme për grupet e marginalizuara sociale.

**Qëndrueshmëria mjedisore:** Qëndrueshmëria mjedisore ka të bëjë me mjedisin natyror dhe me atë sesi ai mbetet i larmishëm dhe produktiv. Meqenëse burimet natyrore rrjedhin nga mjedisi, gjendja e ajrit, ujit dhe klimës përbënë një shqetësim të veçantë. Qëndrueshmëria mjedisore kërkon që shoqëria të hartojë aktivitete për të përmbushur nevojat njerëzore duke ruajtur balancing e jetës në planet. Kjo, për shembull, nënkupton përdorimin e qëndrueshëm të ujit, përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe furnizimin me materiale të riciklueshme.

**Qytet Miqësor me Natyrën i bazuar në energji të gjelbërt dhe të pastërt, reduktim të emetimeve, hapësira të gjelërta dhe hapësira tjera publike të integruara dhe të qasshme për të gjithë, qytet i përshtatshëm për ecje dhe për ciklizëm që derivon nga Planit për EkoMobilitet**

Implementimi i principeve kryesore për të arritur karakteristikat e Qytetit Ekologjik do të fokusohet në disa fusha paralelisht:

- a) Hartimi i politikave dhe ndërmarrja e veprimeve konkrete për të zvogëluar emitimin e gazrave nga komunikacioni, ekonomitë familjare dhe industria;
- b) Krijimi i hapësirave të gjelërta për të arritur standardin minimal të rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (9 m<sup>2</sup>/ban.) si dhe integrimi i tyre, krijimi i hapësirave të reja publike, të qasshme dhe të përdorueshme nga të gjithë,
- c) Krijimi i infrastrukturës dhe ofrimi i sigurisë së nevojshme për ta bërë qytetin të përshtatshëm dhe tërheqës për ecje (koncepti *Walkable City*) – përmes Planit të EkoMobilitetit
- d) Krijimi i infrastrukturës dhe ofrimi i sigurisë së nevojshme për ta bërë qytetin të përshtatshëm dhe tërheqës për përdorimin e bicikletave (koncepti *Bike friendly City*)–përmes Planit të EkoMobilitetit

## **Shërbime Publike Dixhitale: Libraria Dixhitale, Arkiva Dixhitale, Sistemi Dixhital për Leje Ndërtimore, Shërbimet tjera komunale të dixhitalizuara, Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH);**

Për të rritur efikasitetin e shërbimeve, nivelin e qasshmërisë dhe përdorimin e tyre nga sa më shumë përdorues të mundshëm por edhe për t'i ofruar shërbimet sa më afër qytetarëve komuna do të dixhitalizojë shërbimin e bibliotekës së qytetit, arkivës komunale si dhe procesin e aplikimit për leje ndërtimore. Tutje; komuna do të dixhitalizojë pjesën e mbetur pa u dixhitalizuar nga shërbimet e administratës komunale si dhe do të aplikojë Sistemin Informativ Shëndetësor (SISH).

## **Platforma e-Vushtrria (burim i hapur për të gjithë dokumentet e planifikimit hapësinor dhe sektorial, dokumentet zyrtare, shërbimet publike dhe private, biznesin lokal dhe shpalljet e vendeve të reja të punës);**

Komuna e Vushtrrisë do të krijojë një platformë të integruar interaktive në të cilën të gjithë përdoruesit e interesuar do të kenë qasje në dokumentet e planifikimit (Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale, Planet e Hollësishme Rregulluese etj.), strategjitë sektoriale zhvillimore si dhe dokumentet tjera zyrtare. Tutje, në këtë platformë interaktive do të mund të gjenden të gjitha informacionet e nevojshme për infrastrukturës publike/sociale si dhe shërbimet publike dhe private.

Sa i përket infrastrukturës publike dhe sociale, përdoruesit e interesuar do të mund të gjejnë informacione të tilla si lokacioni i objektit, mënyra e qasjes deri te ai lokacion, numri i përdoruesve aktivë si dhe detaje tjera që ndërlidhen me të. Informacione të tilla dhe të tjera të ngjashme do të ofrohen për të gjitha objektet e arsimit, shërbimit shëndetësor, objektet e kulturës dhe rinisë si dhe objektet tjera të infrastrukturës publike sociale.

Ndërsa sa i përket shërbimeve tjera në sektorin publik dhe privat, të gjitha informacionet e nevojshme për adresën, mënyrën e qasjes, kapacitetin si dhe numrin e përdoruesve aktivë për shërbime të tilla si biblioteka publike dhe private, shkolla publike dhe private, shërbime shëndetësore publike dhe private, barnatore, furra të bukës, markete, restaurante dhe kafiteri etj..

Të njëjta informacione do të përdoren edhe për të gjitha bizneset e vogla dhe të mëdha në komunën e Vushtrrisë. Ndërsa të gjitha bizneset do të kenë mundësi dhe hapësirë për t'i shpallur vendet e lira/konkurset e punës.

## **Shërbime Publike dhe Infrastrukturë Teknike e Mëcur:**

- **Menaxhim i Mëcur dhe i Integruar i Resurseve Ujore**
- **Sistem i Mëcur i Transportit, Menaxhim i Mëcur i Trafikut dhe Parkingjeve**
- **Infrastrukturë publike sociale e qasshme për të gjithë, e bazuar në Principet e Dizajnit Universal.**

Për të rritur efikasitetin e shërbimeve, cilësinë e menaxhimit, nivelin e qasshmërisë si dhe nivelin e kënaqshmërisë së përdoruesve, komuna e Vushtrrisë do të punojë paralelisht në menaxhimin e integruar dhe të mëcur të sistemit të ujit, menaxhimin e integruar dhe të mëcur të transportit publik dhe trafikut urban, bashkë me parkingjet si dhe në planifikimin dhe menaxhimin e integruar të hapësirave publike dhe të gjelbërta dizajnimi i të cilave do të bazohet në principet e Dizajnit Universal. Hapësirat publike dhe të gjelbërta, përveç që do të jenë atraktive dhe të përdorshme nga të gjitha grupet sociale, ato të jenë një lloj të qasshme për të gjitha kategoritë sociale, përfshirë edhe qytetarët me nevoja të vecanta.

## 5. TRAJTIMI I TEMAVE ME PRIORITET

### 5.1. MENAXHIMI I MENCUR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Ruajtja e “bërthamës historike” të një qyteti është një ide që njeh vlerën e trashëgimisë dhe përpiket të ruajë identitetin e atij qyteti. Kjo ndikon në cilësinë e jetës së njerëzve të qytetit në aspektin social, kulturor dhe ekonomik. Qëllimi final i menaxhimit të mencur të trashëgimisë kulturore është promovimi, shtimi i vlerës dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore. Objektivi i tij specifik është të rrisë atraktivitetin e turizmit dhe të zvogëlojë sezonalitetin e tij në zona të caktuara.

Faktorët në kategoritë e "jetesës së zgjuar", "njerëzit e zgjuar" dhe "qeverisjen e zgjuar" pjesërisht ndikojnë në atraktivitetin e një lokacioni dhe potencialin e tij për turizëm. Për të shfrytëzuar plotësisht këta faktorë dhe për të maksimizuar potencialin e një zone, proceset e planifikimit dhe menaxhimit duhet të përfshijnë burimet lokale në të gjitha nivelet (La Rocca, 2013). Bazuar në habitatin e saj dhe veçoritë historike dhe kulturore, hapësira historike është diçka më komplekse sesa thjesht shuma e muzeve, zonave arkeologjike, parqeve, arkivave dhe bibliotekave. Qytetet dhe zonat historike realisht duhet të shihen dhe trajtohen si muze të gjalla. Ndërsa sa i përket modaliteteve të menaxhimit të mencur të këtyre hapësirave, është thelbësore që modelet të marrin parasysh të gjitha potencialet për turizmin që janë në gjendje të plotësojnë kërkesat aktuale dhe në rritje të përdoruesve.

Llojet e ndryshme të përdoruesve të përfshirë gjenerojnë burime dhe rrjedha të ndryshme informacioni. Përdoruesi rezident i përket në mënyrë të vendosur komunitetit për shkak të përkatësisë, lidhjeve emocionale me vendin, punës dhe jetës së tij të përditshme. Turisti-përdorues zgjedhë të bashkohet përkohësisht për të verifikuar nëse ai vend i plotëson pritjet e tij/saj. Autoritet lokale-si përdorues duhet të njohin komunitetin për ta qeverisur atë në mënyrë efektive. Ekspertët e TIK-ut duhet ta njohin territorin për ta promovuar atë. Promovimi shkon përtej lokalizimit të trashëgimisë kulturore dhe, në vend të kësaj, aktivizon një process të interaktivitetit dhe të të mësuarit kolektiv që menaxhohet kryesisht nga ekspertë, por në të cilin mund të marrin pjesë të gjithë përdoruesit (Lee & Eicks, 2010). Kjo qasje mund të prodhojë efekte pozitive për trashëgiminë kulturore jo vetëm në qendrat më të mëdha dhe më të dendura urbane, por edhe në zonat më periferike, përmes komplementaritetit dhe integritit.

#### 5.1.1. Propozim për menaxhimin e mencur të trashëgimisë kulturore në Vushtrri

##### **Traseja Kulturore e Vushtrrisë**

Kur bëhet fjalë për aktivitete specifike në lidhje me menaxhimin e mencur të trashëgimisë kulturore, një rezultat kryesor është krijimi i “Trasesë Kulturore”. Ajo realisht është një strukturë rrjetëzimi e aseteve të trashëgimisë kulturore, objekteve të artit dhe kulturës bashkë me adresat e evenimenteve të rëndësishme kulturore. Kjo rrugë do të jetë një tërheqje e re turistike kulturore e cila do të lansohet në tregjet turistike ndërkombëtare duke e pozicionuar qytetin e Vushtrrisë si një destinacion dhe produkt unik të turizmit kulturor.

Një aktivitet i rëndësishëm i realizuar nga projekti është hartëzimi i atraksioneve të trashëgimisë kulturore dhe digjitalizimi i aseteve të trashëgimisë kulturore. Përmes projekteve pilot, trashëgimia e përbashkët kulturore do të paraqitet në mënyrë inovative, dixhitale dhe multimediale për turistët dhe banorët vendas, p.sh. duke krijuar holograme, imazhe 3D, video etj.. Kjo, ndër të tjera çon edhe në përmirësimin e ofertës turistike, dhe rrjedhimisht në zgjatjen e sezonit turistik.

Shënim: Harta e Trasesë Kulturore të Vushtrrisë është paraqitur në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.

### **Krijimi i Hartës Dixhitale Interaktive të Trashëgimisë Kulturore në Vushtrri**

Hartimi dhe digjitalizimi i trashëgimisë kulturore është një veprim i rëndësishëm në funksion të ruajtjes dhe promovimit të saj. Harta Dixhitale Interaktive e Trashëgimisë Kulturore është një aplikacion në internet që kombinon hartat online, arkivat dixhitale dhe multimedien. Kjo hartë fokusohet në kërkimin, ruajtjen dixhitale dhe vizualizimin e trashëgimisë kulturore, materiale dhe jo materiale.

Ofron një mundësi për qytetarët që të ndërveprojnë me trashëgiminë kulturore në një format lehtësisht të arritshëm dhe stimulues, duke mundësuar gjithashtu analiza hapësinore në lidhje me trashëgiminë kulturore. Kjo hartë gjithashtu mundëson mbledhjen e të dhënave dhe analizën e shpërndarjes hapësinore të trashëgimisë kulturore në komunë, qofshin ajo materiale po jo materiale.

### **Përshkrimi Teknik i Hartës Dixhitale Interaktive**

Do të jetë një Hartë dixhitale interaktive, e cila do ta bëjë trashëgiminë kulturore të Vushtrrisë të dukshme dhe të qasshme për të gjithë. Do të jetë një Arkivë Dixhitale e trashëgimisë kulturore të komunës, e cili do të përfshijë:

- Zonat e Mbrojtura të Vecanta në komunën e Vushtrrisë
- Parqet arkeologjike
- Asetet e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përherëshme
- Asetet e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme
- Muzetë
- Galeritë e artit
- Asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rrezik
- Trashëgiminë jomateriale (ushqim tradicional, lojëra tradicionale, etj.)

Materiali i vendosur në Hartën Digjitale Interaktive do të jetë i ndryshëm:

- Materiale vizuale (2D dhe 3D)
- Harta
- Fotografi
- Video
- Virtualizimi i aseteve, objekteve si dhe zonave të rëndësishme përmes Platformës së Realitetit Virtual dhe të Shtuar (AVR)
- Zërim (ciceron dixhital)

Një ID e veçantë do të krijohet për secilën aset të trashëgimisë kulturore, ndërsa kjo IDE do të përmbajë:

- Emërtimin, Adresën dhe Statusin
- Vitin e ndërtimit / krijimit / themelimit
- Historikun
- Numrin unik në bazën e të dhënave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Përdoruesit e Hartës Dixhitale Interaktive do të kenë mundësinë t'i qasen materialit të ekspozuar në 4 Kategorizime:

Kategorizimi 1:

- Trashëgimia Kulturore Materiale
- Trashëgimia Kulturore Jomateriale
- Të gjitha në një vend

Kategorizimi 2:

- Trashëgimia Kulturore Arkitektonike
- Trashëgimia Kulturore Arkeologjike
- Zonat arkeologjike
- Artifakte - Muzetë - Galeritë e artit
- Të gjitha në një vend

Kategorizimi 3:

- Në zonën urbane
- Në zonat rurale
- Të gjitha në një vend

Kategorizimi 4:

- Shfaq në 2D
- Shfaq në 3D

Përveç prezantimit vizual në hartë, të gjitha materialet gjithashtu do të paraqiten në formën e një listimi, sipas kategorive të paracaktuara.



## 5.2. BIBLIOTEKA DIXHITALE<sup>4</sup>

Përparimi i madh dhe i paparë në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) po ndryshon gradualisht mënyrën e funksionimit në të gjitha fushat e jetës. Përparimet e shpejta teknologjike kanë revolucionarizuar edhe rolin e bibliotekave, me E-Libraritë ose Libraritë Dixhitale që po zënë vendin e bibliotekës tradicionale. Në këtë kontekst, bibliotekat po ridizajnojnë shërbimet dhe produktet e informacionit për t'i shtuar vlerë shërbimeve të tyre dhe për të kënaqur nevojat në ndryshim të komunitetit dhe të përdoruesve.

Bibliotekat tradicionale ende po ofrojnë materiale të shtypura, të cilat kryesisht janë të shtrenjta dhe të mëdha. Ndërsa kërkuesit e informacionit nuk po mjaftohen vetëm me këto materiale të shtypura. Ata duan të plotësojnë nevojën e tyre për informacion me burime elektronike, e të cilat janë më dinamike. Andaj, mund të thuhet se kërkesa për informacion dixhital është duke shënuar rritje gjithnjë e më shumë.

Bibliotekat dixhitale përbëhen nga një koleksion burimesh dixhitale. Këto burime mund të ekzistojnë vetëm në format dixhital, por ka edhe burime që janë shndërruar nga një formë tjetër në atë dixhitale. Këto burime ruhen në përgjithësi në një gamë të gjerë formatesh dhe mund të arrihen nga përdoruesit përmes një rrjeti kompjuterik. Bibliotekat e tilla kanë shumë përparësi, duke u nisur nga fakti se ato mund të përditësohen çdo ditë dhe mund të aksesohen menjëherë nga përdoruesit. Për më tepër, ato nuk kanë një kufi fizik, mund të ruajnë më shumë informacion dhe ofrojnë qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në shumë burime njëkohësisht. Bibliotekat dixhitale mund të ndryshojnë në masë të madhe në aspektin e madhësisë, mbulueshmërisë së fushave tematike dhe materialit, si dhe qëllimit të përdorimit. Ato mund të mirëmbahen nga institucionet, organizatat apo edhe vetë individët. Disa institucione, kryesisht akademike, tashmë kanë filluar të krijojnë dhe mirëmbajnë bibliotekat dixhitale.

Përfitimet kyce të bibliotekës dixhitale janë përshkruar si më poshtë:

**Biblioteka dixhitale e sjellë bibliotekën më afër përdoruesit:** Një bibliotekë dixhitale sjell informacionin në tryezën e përdoruesit, në punë ose në shtëpi, duke e bërë më të lehtë përdorimin dhe kështu duke rritur përdorimin e tij. Biblioteka është kudo ku ka një kompjuter personal dhe një lidhje rrjeti.

**Fuqia kompjuterike përdoret për kërkim dhe shfletim të materialeve:** Sistemet kompjuterike tashmë janë më të mira se metodat manuale për gjetjen e informacionit. Kompjuterët janë veçanërisht të dobishëm për punën referuese që përfshinë kalime të përsëritura nga një burim informacioni në tjetrin.

**Informacioni mund të shpërndahet:** Bibliotekat dhe arkivat përmbajnë shumë informacione që janë unike. Vendosja e informacionit dixhital në një rrjet e bën atë të disponueshëm për të gjithë.

**Informacioni është më i lehtë për tu përditësuar:** Shumë informacione të rëndësishme duhet të përditësohen vazhdimisht, dhe këtë e mundëson biblioteka dixhitale lehtësisht.

**Informacioni është gjithmonë i disponueshëm:** Dyert e bibliotekës dixhitale nuk mbyllen kurrë; informacioni do të jetë i disponueshëm kurdo dhe kudo që përdoruesi e dëshiron atë.

---

<sup>4</sup>Aplikacioni për bibliotekën dixhitale të Vushtrrisë është duke u zhvilluar, ndërsa funksionalizimi i tij i plotë është planifikuar të bëhet deri në Dhjetor 2021.

### 5.3. ARKIVA DIXHITALE<sup>5</sup>

Arkivimi dixhital është një depo e materialit dixhital që një kompani, institucion ose person dëshiron të ruajë për një periudhë më të gjatë kohore. Ajo ruan koleksione të informacionit dixhital si dokumente, video, fotografi, harta etj. në një format dixhital me synimin për të siguruar qasje afatgjatë në to. Një arkiv dixhital mund të jetë një koleksion i përpunuar me një sistem magazinimi me shumë nivele ose i vendosur në një hard disk. Materialet e vendosura dhe të ruajtura në arkivë dixhitale mund të ruhen më lehtë nga dëmtimi dhe/apo humbja, ndërsa mund të vërtetohet më lehtë dhe më saktësisht vërtetësia dhe autenticiteti i tyre. Qasja në të dhëna si dhe siguria e tyre janë po ashtu elemente të rëndësishme që mundësohen nga arkiva dixhitale.

#### **Përfitimet nda Arkiva Dixhitale**

Meqenëse arkivat mund të bëhen jashtëzakonisht të mëdha, përfitimi kryesor i arkivimit dixhital është hapësira dixhitale e ruajtjes së materialeve. Një përfitim tjetër nga dixhitalizimi i arkivave është se e bën gjetjen e informacionit më të lehtë. Po ashtu, shumë njerëz mund të kenë të njëjtin informacion në të njëjtën kohë.

Parandalimi i humbjes së të dhënave është më i lehtë me arkivat dixhitale. Edhe pse humbja e arkivave është një rrezik si për atë tradicional (letër, etj) ashtu edhe për atë dixhital, megjithatë, me sistemin dixhital, krijimi i kopjeve rezervë të cilat gjithashtu mund të ruhen në vende të ndryshme është më kosto-efektive sesa krijimi i kopjeve të letrës dhe ruajtja e tyre në një vend tjetër.

Përfitimet kyce nga implementimi i konceptit Arkivë Dixhitale janë përmbledhur si më poshtë:

**Ruatja e të dhënave,** e cila është e vështirë të bëhet në arkivat klasike (fizike) lehtësohet shumë në rastet kur bëhet dixhitalizimi i arkivave.

**Miqësore ndaj mjedisit:** Njëra ndër përfitimet madhore nga dixhitalizimi i arkivave është se eliminon nevojën e ruajtjes së materialeve fizike, rrjedhimisht eliminon nevojën e krijimit dhe zgjerimit të hapësirave fizike. Kjo ndihmon në përpjekjet për ruajtjen e mjedisit.

**Konfidencialiteti i të dhënave:** Dixhitalizimi i arkivave ndihmon edhe në konfidencialitetin e të dhënave. Kështu, të dhënat e ndieshme në formatin dixhital mund të ruhen shumë më lehtë sesa në verizonin e tyre fizik. Rreziku i ekspozimit të të dhënave të ndieshme mund të mos eliminohet plotësisht, por gjithsesi minimizohet.

**Qasje e shpejtë në materiale:** Arkivimi dixhital i të dhënave siguron qasje më të shpejtë në materialet e arkivuara. Siguron edhe kërkim më efikas për informacionin dhe/apo dokumentin e caktuar. Ai gjithashtu lidhë të dhënat e ruajtura në vende të ndryshme dhe të mirëmbajtura nga institucione të ndryshme duke i bërë koleksionet arkivore, të qasshme nga kushdo dhe kudo.

**Eficientë ekonomike:** Arkivat dixhitale janë shumë më ekonomike sepse mundësojnë kursime të mëdha të letrës dhe shtypit. Shpenzimet për transportimin e kopjeve fizike të materialeve nga një vend në tjetrin është një çështje tjetër të cilën e eliminon arkivimi dixhital.

**Ri-kthimi i lehtë i të dhënave:** Në arkivat fizik, në rastet kur materiali i caktuar humbë, gjetja dhe/apo rikthimi i tij mund të jetë shumë e vështirë, madje edhe i pamundur. Mirëpo, rikthimi i të dhënave dhe/apo materialeve të arkivuara në mënyrë dixhitale shpesh është i mundshëm dhe i lehtë.

---

<sup>5</sup> Aplikacioni për arkivën dixhitale është duke u zhvilluar, ndërsa dixhitalizimi i arkivës komunale të Vushtrrisë është planifikuar të bëhet deri në Dhjetor 2021.

## 5.4. SISTEMI ELEKTRONIK PËR LEJE NDËRTIMORE (E-LEJA)<sup>6</sup>

**E-Leja** është një grup mjetesh dhe shërbimesh të bazuara në kompjuter që dixhitalizojnë dhe thjeshtësojnë procesin e aplikimit dhe dhënies së lejes së ndërtimit. Qëllimi i E-Lejes është të shkurtojë kohën e tërë procesit të aplikimit, shqyrtimit dhe marrjes së vendimit për leje ndërtimore. Ajo lejon aplikuesit të bëjnë aplikimin në mënyrë direkte në departamentin përkatës, lejon departamentin e lejeve ndërtimore të shqyrtojë aplikimin dhe të kërkojë dokumente dhe/apo sqarime shtesë, lejon publikimin e vendimit online si dhe arkivon të gjithë materialin dhe komunikimin e bërë gjatë procesit. Kjo ndikon drejtpërsëdrejti në përmirësimin e cilësisë shërbimit ndaj aplikuesve si dhe efikasitetin e stafit. Një sistem elektronik i lejeve zëvendëson të gjitha proceset, procedurat dhe veprimet tradicionale që kanë të bëjnë me lejen ndërtimore. Thejshëtizimi i gjithë procesit është aq i madh sa një mjet i vetëm softuerik mjafton edhe për procesin e aplikimit, gjurmimin e lejeve, inspektimin etj, ndërsa softueri i njëjtë mund të përmbajë edhe mjete të tjera që ndërlidhen me monitorin e gjithë procesit, disa prej të cilave janë radhitur si më poshtë:

- Konsultimet me dokumentet e planifikimit në fuqi
- Inspektimet
- Llogaritja dhe mbledhja e taksave
- Menaxhimi dhe Monitorimi i procesit të punës
- Komunikimi me aplikuesit përmes shërbimit të bazuar në ueb
- Komunikimi dhe menaxhimi i procesit brenda departamentit të njëjtë si dhe procesit ndërmjet departamenteve të ndryshme.

Aplikuesit për leje ndërtimore përmes sistemit e-Leja duhet të hapin një llogari nga e cila bëjnë aplikimin dhe e përcjellin të gjithë procesit. E-Leja iu mundëson aplikuesve që të kenë qasje edhe kur i tërë procesi të jetë përmbyllur, e kjo është e mundur falë aftësisë së aplikacionit për të arkivuar të gjithë dokumentacionin dhe procesin e aplikimit për leje ndërtimore.

Edhe pronarët e pronave dhe objekteve që do të ndërtohen, edhe arkitektët edhe inxhnierët e ndërtimit mund të hapin llogaritë e tyre në aplikacion në cilësinë e personit fizik. Ndërsa e njëjta është e mundur edhe për persona juridik, të tillë si kompani të projektimit dhe punëkryesit.

### **Përfitimet e përvetësimit dhe aplikimit të e-Lejës**

- Informacione të standardizuara për adresat dhe parcelat e objekteve
- Grumbullimi i të dhënave për objektet dhe arkivimi i tyre
- Lehtësimi dhe rritja e komunikimit mes stafit dhe aplikuesve
- Lehtësimi i procesit të konsultimit më planet hapësinorë në fuqi
- Rritje e cilësisë dhe efikasitetit të inspektimit dhe lehtësim i procesit të raportimit
- Përdorim më eficient i kohës së stafit dhe reduktim i punës së shumëfisht
- Menaxhim më i mirë i brendshëm dhe komunikim më i mirë dhe më i lehtë ndërmjet departamenteve të ndryshme: Targetim dhe zgjidhje më efektive e problemeve të identifikuara
- Menaxhim i përmirësuar i taksave që vijnë nga lejet ndërtimore etj.

<sup>6</sup> Linku i qasjes në e-Leja për komunën e Vushtrrisë, e cila tashmë është funksionale: [komuna.e-vushtrrisë \(ubt-uni.net\)](http://komuna.e-vushtrrisë.ubt-uni.net)

## 5.5. RRJETI I INTEGRUAR I WI-FI PUBLIK

Në ditët e sotme, teknologjitë Wi-Fi janë adaptuar gjerësisht dhe luajnë një rol të madh në rritjen e cilësisë së jetës së njerëzve. Mëposhtë shpjegohet se si shoqëria jonë mund të përfitojë nga qasja publike në Wi-Fi, si një mënyrë për të përmirësuar mirëqenien e saj dhe për t'u bërë më efikase:

### **Spektori i Administratës Publike**

Wi-Fi publik është një mundësi e madhe për qeveritë që të lidhin qytete të tëra. Qytetet e mençura që përdorin Wi-Fi falas po rriten në masë të madhe dhe si rezultat, mund të fuqizojnë në mënyrë efektive komunitetet e tyre me shërbime më të mira.

Për shembull, partneri i autorizuar i Tanaza, Tacira, një kompani braziliane integruar dhe ofrues i zgjidhjeve, ofron shërbime digjitale të mençura, si menaxhimi i mençur i mbeturinave, sistemi i mençur i sigurisë dhe ndriçimi i mençur në hapësirat publike gjithandej Brazilit, duke u mbështetur në një infrastrukturë "Wi-Fi cloud".

Një avantazh tjetër që sjell qasja publike në Wi-Fi për komunitetet përfaqësohet nga bibliotekat publike: të gjithë, madje edhe ata që nuk mund të përballojnë internetin në shtëpi, mund të përfitojnë nga një lidhje falas dhe ta përdorin atë për të hyrë në shërbimet publike, për të kërkuar punë ose për argëtimin e tyre personal, pra mësimin e një gjuhe të re.

Pajisja e transportit publik me qasje falas Wi-Fi është një shembull tjetër se si Wi-Fi publik ndikon pozitivisht në komunitetet: banorët dhe udhëtarët mund të gëzojnë një përvojë më të mirë udhëtimit dhe të marrin informacion në kohë reale në lidhje me transportet, në mënyrë që të planifikojnë më mirë rrugët e tyre.

Për më tepër, statistikat tregojnë se 40% e bllokimeve të trafikut në qendrat e qyteteve është si rezultat i shoferëve që kërkojnë vende parkimi. Në këtë drejtim, qyteti i Barcelonës, e zgjidhi këtë problem të mbingarkesës së trafikut duke miratuar sensorë të veçantë parkimi, të cilët punojnë me një aplikacion online dhe u tregojnë qytetarëve se ku ka zona parkimi të disponueshme.

Qasja publike në Wi-Fi mund të ketë një ndikim të madh edhe në turizëm. Kur udhëtojnë, me të vërtetë, njerëzit duan të qëndrojnë në kontakt me familjen dhe miqtë e tyre, të ndajnë fotografitë e tyre të pushimeve në rrjetet e tyre sociale dhe të kontrollojnë informacionin e udhëtimit. Si pasojë, turistët janë më të stimuluar të udhëtojnë për një destinacion nëse mund të përdorin internetin falas. Sigurimi i një qyteti me pika të Wi-Fi falas do të ishte i favorshëm si për turistët, të cilët do të gëzonin lidhje interneti pa tarifa roaming, ashtu edhe për ekonominë lokale, e cila do të përfitonte kryesisht nga nivelet e rritura të turizmit.

### **Spektori i arsimit**

Duke siguruar Wi-Fi falas për studentët dhe stafin akademik, institucionet arsimore mund të shfrytëzojnë arsimin për të përmirësuar kurrikulën e studimeve të tyre digjitale. Shembuj të zbatimit efektiv të Wi-Fi falas në shkolla janë Neë Taipei City, Taiëan, i cili në 2015 prezantoi tableta dhe kompjuterë në 300 shkolla, dhe Shkolla e Dizajnit LSD e Lisbonës, Portugali, e cila, falë Tanaza Wi-Fi, u siguron studentëve dhe stafit një rrjet Wi-Fi të qetë dhe të besueshëm që nga viti 2015. Në këtë mënyrë, studentët dhe mësuesit mund të përdorin në mënyrë efektive pajisjet e aktivizuara me Wi-Fi për qëllime edukative dhe, në të njëjtën kohë, institucioni mund të zhvillojë teknika novatore të mësimdhënies bazuar në mësim bashkëpunues dhe ndërveprues.

Për më tepër, falë shërbimeve ËiFi falas, teknikat e arsimit të mençur mund të jenë në majë të gishtave të kujtudo dhe kudo, gjë që rrit përfshirjen digjitale: njerëzit që vijnë nga zona të pa privileguara mund të marrin kurse online falas, duke përfituar nga bollëku i shërbimeve arsimore online të disponueshme (libra elektronike, MOOC, etj). Falë Wi-Fi, teknologjia e informacionit dhe komunikimit ka kapërcyer distancën gjeografike dhe sociale, duke homogjenizuar shoqërinë tonë.

### **Sektori i kujdesit shëndetësor**

Teknologjia Wi-Fi e aplikuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor përmirëson në masë të madhe performancën e spitaleve dhe klinikave. Për shembull, falë aplikacioneve, mjekët mund të kenë qasje të menjëhershme në informacionin klinik të pacientëve të tyre dhe të komunikojnë lehtësisht me ta. Për më tepër, Wi-Fi publik lehtëson kujdesin shëndetësor rural: në të vërtetë, pacientët që jetojnë në zonat rurale mund të përdorin rrjetin e tyre ËiFi për të kontaktuar mjekët në distancë. Në të njëjtën kohë, ËiFi lejon monitorimin e vendndodhjes në kohë reale, që do të thotë se ju lejon të gjurmoni pozicionin e stafit mjekësor brenda një ndërtese të kujdesit shëndetësor dhe të planifikoni më mirë përdorimin e burimeve: si pacientët ashtu edhe pajisjet mund të drejtohen te vendin e duhur në kohën e duhur.

### **Sektori komercial**

Sipas një raporti nga Cisco, pikat e nxehta publike ËiFi pritet të rriten nga 8.8 milion në 2016 në 15.3 milion deri në vitin 2021. Ky parashikim optimist lidhet me të ardhurat pozitive që bizneset si dyqanet me pakicë, restorantet, baret, kafenetë, sallonet, hotelet dhe qendrat tregtare, ndër tjerash, kanë përfituar nga ofrimi i lidhjes falas ËiFi për klientët e tyre. Konsumatorët, nga ana tjetër, mund të shfrytëzojnë lidhjen ËiFi të arritshme lirshëm gjatë blerjes. Për më tepër, lidhjet falas ËiFi të disponueshme në vendet publike mund të jenë një zgjidhje për njerëzit që nuk mund të përballojnë lidhje shtëpiake me brez të gjerë-tarifat e të cilëve janë goxha të larta në disa vende.

Sa i përket mikpritjes, sipas një studimi nga Systemagic, Wi-Fi falas dhe me shpejtësi të lartë, së bashku me lidhje të mirë përsa i përket gjerësisë së brezit, janë mjete të fuqishme për hotelet për të rritur kënaqësinë e klientit. Raporti tregon se, në vitin 2016, 65% e mysafirëve të Roomzzz, një zinxhir anglez apartotelësh, kishin qasje në Wi-Fi falas brenda 7 minutave nga regjistrimi dhe një e katërta e mysafirëve zbuluan se nuk do të zgjidhnin një hotel që nuk e kishte bërë. t ofroni shërbime falas Wi-Fi. Investimi në shërbime më të mira Wi-Fi në industrinë e mikpritjes është, pra, thelbësor për tërheqjen e turistëve dhe përmirësimin e përvojës së mysafirëve. Në të njëjtën kohë, investimet në shërbimet Wi-Fi mund të përfitojnë nga ekonomia lokale për shkak të rritjes në sektorin e saj të turizmit.

#### **5.5.1. Zgjidhja e propozuar për qytetin e Vushtrrisë, për Rrjetin e Integruar të Wi-Fi Publik**

Në tërë zonën urbane të qytetit të Vushtrrisë janë vendosur 5 pika të qasjes (Access Point) në Wi-Fi, të cilat mbulojnë gjithë zonën, ndërsa janë marrë parasysh pikat kryesore të qytetit të cilat janë më të frekuentuara.

**Pika I-rë** përfshinë pjesën hyrëse të qytetit të Vushtrrisë nga Mitrovica. Në hyrje të qytetit gjendet Qendra e Mjeksisë Familjare dhe Xhamia, të dy këto objekte gjenden në afërsi të njëra tjetrës.

**Pika e II-të** përfshinë pjesën e qytetit mbi rrugën magjistrale e që mbulonë shkollën fillore dhe e mesme e ulët “Anton Zako-Çajupi”, Qendren e Mjeksisë Familjare e cila gjendet në oborrin e kësaj shkolle, xhamin “Haxhi Ejupi”, një qerdhe private dhe palestren sportive private “Forca”.

**Pika e III-të** përfshinë pjesën e qendrës së qytetit dhe institucionet më të rëndësishme të qytetit duke filluar nga shkolla fillore “Mustaf Venhari” së bashku me qerdrhen publike që gjendet në të njetin oborr si dhe në afërsi kanë objektin e Gjykatës së Vushtrrisë. Pika e III-të mbulon palestren sportive “Jeton Tërrstena-Tota”, Uren e gurit, shetitoren “Enver Zymberi”, tregun aktual, shkollën fillore “Naim Frasheri”, Muzen e qytetit, xhamin “Gazi Ali Begut”, Hamamin e qytetit, sheshin “Ahmet Krasniqi”, ndërtesën e Komunës, sheshin “Hasan Prishtina”, xhaminë e Çarshisë, shtëpin e Kultures “Hasan Prishtina”, bulevardin “Adem Jashari”, Kalanë e qytetit, Norëalk parkun, SHMU 2, Shkollën e Policisë, Stacionin Policior, Spitalin, QKMF-në. Në këtë pikë përfshihen edhe qerdrhja publike.

**Pika e IV-të** përfshinë dy shkollat e mesme të larta: shkolla profesionale “Bahri Haxha” dhe shkolla teknike “Lutfi Musiqi”, sheshin “Adem Jashari”, Prakun e qytetit, stadiumin e qytetit, stadiumin e ashtuquajtur “palestra e gumes”, hapësirën e ish motel Vicanumit, shkollën fillore “Ali Klemendi”, SHMU1 si dhe gjimnazin “Eqrem Çabej”.

**Pika e V-të** përfshinë një numër shumë të vogël të ndërtesave publike pasi që Vushtrria ka qendër të dendur dhe koncentrimi i shumicës së institucioneve dhe hapësirave gjenden në qendrën e qytetit, pika e pestë përfshinë shkollë fillore “Ali Kelmendi” si dhe qerdrhen e tretë publike e cila publike e cila është e re dhe përruruar rishtazi.

Shënim: Paraqitja e grafike e Rrjetit të Integruar të Wi-Fi Publik në qytetin e Vushtrrisë është bërë në Shtojcën 2 të këtij dokumenti.

## 5.6. DIZAJN I INTEGRUAR DHE I QËNDRUESHËM I HAPËSIRAVE TË GJELBËRTA DHE ATYRE PUBLIKE

### **Hapësirat publike dhe nevoja për qasje të integruar dhe dizajn të qëndrueshëm**

Në antikitet, tregu, sheshi dhe të tjera të ngjashme, në gjuhën greke përfshiheshin nga fjala agora. Në shtet-qytetet Greke, agora ishte një zonë për qytetarët e lirë për të përcaktuar në mënyrë administrative ose komerciale nevojat e tyre publike. Përdorimi i dendur dhe i rreptë i agorës përshkruan një përvojë primitive për hapësirën publike (Ëycherley:1993). Në mënyrë të ngjashme, Carmona dhe të tjerët (2008) vlerësojnë hapësirën publike përmes historisë, veçanërisht hapësirën publike perëndimore nga Antikiteti të Rilindja dhe Baroku deri në Modernizëm.

Akkar Ercan dhe Memlük (2015) nënvizojnë dy grupe argumentesh mbi literaturën e hapësirës publike. E para përcaktohet nga studiues kritikë si Sennett, Sorkin, Mitchell dhe Banerjee të cilët vlerësojnë hapësirën publike brenda termave të publicitetit dhe përfshirjes. Ata përmendin terma në lidhje me privatizimin, komodifikimin dhe komercializimin e hapësirës publike, të cilat kryesisht janë elemente thelbësore në ristrukturimin urban. Ndërsa grupi i dytë, i cili përfaqësohet nga Akkar, Paddison dhe Sharp, De Magalhas, Németh dhe Schmidt, Carmona dhe Eunderlich, si dhe Langstraat dhe van Melik përqendrohen tek pyetja "kush", dhe përcaktimi i formave publike, proceset gjithëpërfshirëse të prodhimit, menaxhimit, bashkësive lokale, të drejtave qytetare dhe rutinat e jetës së përditshme. Debatet bashkëkohore rreth hapësirës publike përqendrohen në idealin ose përfshirjen e hapësirës në qytete. Në mënyrë të ngjashme, Madanipour (1996) shprehet se hapësira publike thekson aksesin e hapur ose në hapësirë ose në larminë e aktiviteteve, më së shumti në ndërveprimin shoqëror, që ndodhë në të.

Hapësirat publike brenda secilës lagje, siç janë hapësirat e hapura, rrugët dhe vendet e grumbullimit, janë faktorët kryesorë për të krijuar komunitete të jetueshme. Gehl dhe Svarre (2013) përshkruajnë hapësirën publike "si rrugë, pasazhe, ndërtesa, sheshe, shtylla: gjithçka që mund të konsiderohet pjesë e mjedisit të ndërtuar". Ndërsa Ercan përshkruan hapësirën publike si " një hapësirë që ka të bëjë me njerëzit në tërësi, e hapur për të gjithë, e arritshme ose e ndarë nga të gjithë anëtarët e komunitetit, e siguruar nga autoritetet publike për përdorimin e njerëzve në përgjithësi ". (Ercan: 2010). Ajo gjithashtu përshkruan vendin publik si "një vend që kontrollohet nga 'aktorët publikë' dhe përdoret nga një publik i përbërë nga sfera të mbivendosura të grupeve të aktorëve privatë." (Ercan: 2010) Një tjetër shpjegim rreth hapësirës publike është se të gjitha pjesët e një strukture urbane të cilat janë të arritshme fizikisht dhe vizualisht për të gjithë, konsiderohen si hapësirë publike. (Masihi et al., 2015)

**Nevoja për qasje të reja e të qëndrueshme** ndaj hapësirave publike është thelbësore ngase hapësirat publike nuk mungojnë mirëpo ato nuk kanë komunikim mes veti, gjë që i bënë edhe më pak të shfrytëzueshme. Për këtë duhet të bëhet lidhja ndërmjet këtyre hapësirave ekzistuese me shtigje të reja, sheshe, vendkalime për këmbësor, vendosja dhe mirëmbajtja e rampave për personat me karroca, trotuareve të qasshme për personat e verbër dhe vendosja e sinjaleve zanore.

Hapësirat publike në secilin qytet në Kosovë nuk janë të mirëfillta dhe nuk shfrytëzohen nga qytetarët për kohë të gjatë, ngase nuk janë të dizajnuara sipas principeve të dizanit të qëndrueshëm

urban. Kjo bënë që ato të shfrytëzohen vetëm nga një grup i shoqërisë e nga pjesa tjetër të përdoren vetëm për të kaluar nëpër to.

Ndërsa në anën tjetër, hapësirat publike duhet të jenë të qasshme për të gjithë, dhe të shfrytëzueshme nga të gjithë. Kjo ndodhë vetëm kur krijohen kushtet e përshtatshme për të gjithë pa anashkalim, ndërsa aplikimi i principeve të dizajnit të qëndrueshëm urban do të mundësonte një gjë të tillë.

Principet e Dizajnit të Integruar dhe të Qëndrueshëm Urban mund të përmbliken si më poshtë:

- Ruajtja e identitetit hapësinor dhe urban;
- Përdorimi i përzier;
- Ecshmëria;
- Qasja;
- Qëndrueshmëria dhe Jetueshmëria;
- Gjithëpërfshirja.

### **Përfitimet e Dizajnit të Integruar dhe të Qëndrueshëm të Hapësirave Publike**

Studime të shumta kanë dhënë prova të mbështetura nga hulumtime të ndryshme për të treguar përfitimet e dizajnit të qëndrueshëm urban, dhe atë si vijon:

#### **a. Përfitimet mjedisore**

**Cilësi e përmirësuar e ajrit:** Ecja, çiklizmi dhe transporti urban mund të ulin emetimet e transportit, të cilat përbëjnë më shumë se 20-30 përqind të ndotjes së ajrit në qytet.

**Ndotja më e vogël nga karboni:** Dizajni më i mirë urban mund të zvogëlojë ndotjen nga karboni në sektorin e transportit, i cili përbën gati një të katërtën e emetimeve të gazeve serë në lidhje me energjinë e planetit.

**Ulja e përdorimit të makinave:** Programet e furnizimit me biçikletave dhe korsitë e dedikuara për to ofrojnë alternativa në vend të automjeteve private. Për shembull, në Kinë, më shumë se çdo vend tjetër, janë aplikuar 138 programe për dhënien e biçikletave deri në fund të vitit 2014.

#### **b. Përfitimet ekonomike**

**Kosto më e ulët për banorët:** Familjet mund të kursejnë para, duke zëvendësuar përdorimin e energjisë në atë efikente gjatë udhëtimeve, njëkohësisht qasje më të lehtë në përdorimin e funksioneve të përziera, dhe kosto më të ulët të parkimit.

**Kosto të reduktuara të dyndjeve në trafik:** Dizajni i qëndrueshëm mund të sjellë lëvizshmëri të organizuar (grupore) dhe të zvogëlojë shpenzimet ekonomike të lidhura me trafikun, që arrijnë mesatarisht në 8 % të PBB-së (Prodhimi i Brendshëm Bruto).

**Prona me vlerë më të lartë:** Studimet nga e gjithë bota tregojnë se ecshmëria dhe mundësia e përdorimit të transportit publik rrisin vlerat e patundshmërisë.



**Produktiviteti i përmirësuar:** Dendësia rrit produktivitetin dhe inovacionin përmes efektit të lidhjeve; në të kundërt, mbingarkesa dhe ndotja dëmtojnë aktivitetin ekonomik dhe shëndetin e njeriut.

**Të ardhura më të larta të qeverisë:** Duke zgjedhur strategji të mençura të zhvillimit, qeveritë mund të ulin kostot e projekteve kapitale, punës dhe mirëmbajtjes. Globalisht, 3 trilion dollarë në investime kapitale në infrastrukturën urbane mund të kursehen në 15 vitet e ardhshme duke ndjekur strategji më kompakte në përputhje me principet e dizajnit të qëndrueshëm urban.

### c. Përfitimet sociale

**Përmirësimi i shëndetit publik:** Zhvillimi me përdorim të përzier, orientimi në zhvillimin e transportit publik rrit aktivitetin fizik, ndërsa dështimi i këtij zhvillimi dhe rritja e përdorimit të makinave shoqërohen me rreziqe më të larta të mbipeshës dhe kancerit të zorrës së trashë. Komunitetet e dizajnuara në mënyrë të qëndrueshme gjithashtu ofrojnë rrugë më të sigurta dhe zvogëlojnë dëmet e lidhura me trafikun.

**Lëvizshmëria më e madhe e njerëzve:** Lëvizshmëria më e madhe kursen kohë të humbur në bllokime të trafikut dhe zgjeron zgjedhjet ekonomike dhe jetësore për banorët e qytetit. **Rritja e qasjes së barabartë:** Në një kornizë me qendër makinën, banorët me të ardhura të ulëta shpesh lihen jashtë llogaritjes së planifikimit. Duke ndërtuar mobilitet më të mirë publik, trotuare dhe shtigje biçikletash, ata që nuk kanë mundësi të përdorin makina, fitojnë qasje më të madhe në qytet.

#### 5.6.1. Zgjidhja e propozuar për Dizajnin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të Hapësirave të Gjelbërta dhe Publike për Qytetin e Vushtrrisë

Për të siguruar një rrjet të integruar të hapësirave të gjelbërta dhe atyre publike brenda zonës urbane të qytetit të Vushtrrisë, janë propozuar shiriti dhe shtigjet e gjelbra. Këto akse lidhin rrugë kryesore të qytetit me hapësirat publike, hapësirat e gjelbërta si dhe me hapësirat dhe objektet kryesore të infrastrukturës publike, sociale dhe ato afariste. Në këtë mënyrë, pikat, vendet dhe hapësirat më të frekuentuara të qytetit janë lidhur mes vete për të siguruar një rrjet funksional të komunikimit mes vete. Me këtë propozim, hapësirës urbane të qytetit të Vushtrrisë përveç që do t'i shtohet funksionaliteti, ajo do të pasurohet edhe në aspektin estetik si dhe do t'i shtohet gjallëria. Në këtë mënyrë, hapësirat publike dhe të gjelbërta do të shndërrohen nga vende nëpër të cilat qytetarët kalojnë kalimthi në hapësira në të cilat qytetarët ndalen dhe kalojnë kohë në to. Dizajni i tyre do të bëhet duke u bazuar në principet e dizajnit universal, andaj këto hapësira do të jenë gjithëpërfshirëse. Në këtë mënyrë, përveç që do të sigurohet barazi më e madhe sociale, këtyre hapësirave do t'u shtohet diversiteti, e të dyja këto do t'i shtojnë gjallëri qytetit.

Kështu; krijimi i **shiritit të gjelbër** parashihet përgjatë rrugës magjistrale M2 si mbrojtës ndaj zhurmës dhe pluhurit të automjeteve që qarkullojnë në këtë rrugë e që në hyrje të qytetit do të degëzohet për nga qendra e qytetit antik. Bazuar në zgjerimin e fundit që është bërë në rrugën magjistrale që kalon përmes qytetit të Vushtrrisë vërehet mungesë e madhe e gjelbërimit të lartë dhe të ulët. Këta dy shirita të gjelbër do të sigurojnë, mbrojtjeje akustike nga zhurma që krijohet nga lëvizja e automjeteve, nga pluhuri si dhe do t'i japin rrugëve dimensionin human dhe mikpritës të qytetit, pasi që kjo është rruga kryesore nga e cila vinë dhe shkojnë njerëzit, automjetet e transportit, mallrave dhe shërbimeve. Ky shiriti fillon me zonën urbane në hyrje të qytetit nga Prishtina dhe përfundon me përfundim të zonës urbane në fshatin Banjskë në drejtim të Mitrovicës. Segmenti i këtij shiriti gjelbërues i cili futet në qendrën e qytetit kalon përmes shkollave fillore dhe të mesme e ulët “ Ali Klemendi” dhe lokacionit të ish Motel Vicianumit dhe vazhdon për në drejtim të parkut të qytetit duke e bërë integrimin e parë në rrjetën e hapësirave publike. Pas integritit të parkut të qytetit kalohet menjëherë tek sheshi “Adem Jashari” e pas sheshit tek bulevardi “Adem Jashari” që ndarje sheshi dhe bulevardi e kanë vetëm rrugën “ Ahmet Selaci”. Bulevardi “Adem Jashari” tangjenton Kalanë e qytetit, njërin nga monumentet kryesore të qytetit antik. Pas përfundimit të bulevardit shiriti vazhdon përgjatë xhamisë së Çarshisë dhe shtëpisë së Kulturës “Hasan Prishtina” për tu kthyer nga Banesat e Kuqe dhe për të vazhduar në drejtim të Urës së Gurit dhe më pas në drejtim të Lumit Silnica ku dhe mbyll çarkun. Me tu bashkuar me shëtitoren “Enver Zyberi” apo e njohur edhe si “ te Bankinat” shënon lidhjen e hapësirave publike siç janë: Parkun e qytetit, sheshin dhe bulevardin “Adem Jashari”, Kalanë e qytetit, xhaminë e Çarshisë, Norëalk parkun, shtëpinë e Kulturës, memorialin, Urën e Gurit dhe shëtitoren “Enver Zymberi”.

### **Shtigjet e gjelbra**

Shtigjet e gjelbra mbulojnë gjatësi më të mëdha të rrugëve lokale të qytetit të Vushtrrisë me fokus të veçantë tek këmbësorët të cilët i frekuentojnë këto rrugë. Rëndësi e veçantë e këtij rrjeti të hapësirave publike do të jetë “shtegu historik” i cili do të jetë vazhdimësi e nismës për lidhjen e hapësirave publike “A ëalk in history”. Shtegu “historik” do të fillojë aty ku fillon “A ëalk in history” apo përfundimi i bulevardit “Adem Jashari” dhe gjatë rrugës do të kalon përgjatë xhamisë së Çarshisë, Hamamit “Gazi Ali Begut”, sheshit “Ahmet Krasniqi” dhe do të vazhdojë përgjatë xhamisë “Gazi Ali Begut” në drejtim të Muzeut të qytetit apo shtëpisë së “Mahmut Agë Gjinollit” për të vazhduar përgjatë Lumit “Tërstena” në drejtim të magjistrales.

Shtegu i gjelbër tjetër do të mbulojë segmentin e rrugës “Gjergj Kastrioti- Skënderbeu” i cili fillon nga qendra e qytetit dhe vazhdon në drejtim të shkollës së Policisë së Kosovës dhe mbaron në rreth rrotullimin në magjistralen në dalje të qytetit në drejtim të Mitrovicës.

Shtegu i tretë fillon nga Muzeu i qytetit dhe vazhdon përgjatë lumit “Tërstena” në drejtim të lumit “Silnica” deri tek shëtitoretja “Enver Zymberi” e së bashku me segmentin nga Muzeu i qytetit përgjatë Lumit “Tërstena” në drejtim të magjistrales përbëjnë shtegun i cili ligj shiritin e rrugës magjistrale me lumin “Silnica”.

Lumi “Tërstena” kalon përmes qytetit të Vushtrrisë dhe bashkohet me Lumin “Silnica” dhe vazhdojnë së bashku në drejtim të Mitrovicës. Vend bashkimi i lumenjve ndan edhe Bankinën e cila është e vendosur

përgjatë lumit “Silnica”, shtegu i gjelbër i radhës vazhdon në anën e kundër të shëtitores “Enver Zymberi” dhe kufizon komplet pjesën e qytetit dhe vazhdon në drejtim të varrezave të vjetra të qytetit për tu bashkuar me segmentin i cili kalon përgjatë lumit “Tërstena” në drejtim të magjistrales.

Segmenti i radhës drejtvizor është nga rreth rrotullimi i rrugës magjistrale në drejtim të fshatit Gojbulë, i cili lidhet me shiritin e gjelbër të rrugës magjistrale dhe përfundon me përfundim të zonës urbane të qytetit.

Segmenti tjetër i gjelbër i rrjetës urbane është ai i cili kalon përgjatë lumit Studime e që fillon nga shiriti i gjelbër i rrugës magjistrale në hyrje të qytetit të Vushtrrisë dhe vazhdon në drejtim të fshatit Studime përgjatë zonës urbane. Si dhe segmente të vogla për integrimin e hapësirave që do të realizohen në të ardhmen.

Vendosja e këtij rrjeti të integruar të hapësirave publike të qytetit të Vushtrrisë lehtëson lidhjet dhe integrimet e ardhshme të hapësirave të planifikuara apo të atyre që planifikohet në të ardhmen, kjo për faktin se kjo rrjetë mbulojnë segmentet kryesore rrugore dhe më të rëndësishme të qytetit dhe të hapësirave publike, të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit antik të Kosovës , të Vushtrrisë.

Shënim: Paraqitja e grafike Dizajnit të Integruar dhe të Qëndrueshëm të Hapësirave të Gjelbërta dhe Publike për Qytetin e Vushtrrisë është bërë në Shtojcën 3 të këtij dokumenti.